

BIBLIOTEKA
SHTETIT

814-2
PSO

ne nē folur pér kē... ne, nu pa përmendur mijal reguesin. Ky e tē alit i pëlgët sh... mijalti. Ai i zbul mirë foletë e jetë... nuk u sirohet dë mësuai vendoi ku ka mijaltë, ai shkon njeriun. Hoxhojet rreth tij dë ciciron shun Ai i... me kembengulje që njeriu tē v... qe njeriu tē bëjë siller po i me nere fluturon dë cicët eteve... o sh... thehi... er tu... jek... tiu a... Ku... zogu... llhet... nend... iqinë... tij s... lole... jeriu... flutu... ro...

Kolec Pepa

MOZAIK HUMORISTIK

891.P83-7



KOLEC PEPA, ka lindur
ë qytetin e Shkodrës në vi-
n 1936. Ka mbaruar Institu-
tut e Lartë Pedagogjik dhe sot
unon si arësimtar në rrethin
Shkodrës.

Prej vitesh ka botuar në
ganet tonë të shtypit, si në
«Hosteni» dhe «Sporti» shkri-
e humoristike.

Sot del para lexuesit me
rin e tij të parë «Mozaih
moristik».

854-7

PSC

KOLEC PEPA

MINISTERI PUBLIKAT

MOZAIK

Humoristik



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

RRAPUSHI PËRGJEGJET

Jo vetëm me shkresë, por edhe me anë të shtypit lokal u lajmërua se në shkollën ku është drejtor Latif Tuli, megjithëse zonë malore, u hap këtë vit shkolla e mbrëmjes. Këtë lajm e vlerësuan jo vetëm të interesuarit, duke filluar nga banorët e fshatit, por edhe kolegët e Latifit dhe miqtë e tij.

— I lumtë Latif Tulin! — tha Zeneli, shok i tij, punonjës në ndërmarrjen e ujërave.

— Përgëzime! — thanë edhe arësimtarët e fshatrave fqinjë.

— Kjo iniciativë duhet të na vejë në lëvizje të gjithë ne, kolegët e Latifit.

«Tri herë në jayë do të vazhdojmë mësimet» fliste me vete Latifi, kur hysri në këshillin pedagogjik të merrte regjistrin e notave. «Çdo ditë tri apokatër orë mësim. Mendoni pastaj se sa orë suplementare do të grumbullohen deri në fund të vitit shkollor... Apo nuk mieren të gjithë lekët së bashku në kohën më të përshtatshme. Izëtu duket që nuk do të mëndahen në çdo mbledhje apo seminar që mund të organizohet.»

... Ishin ditët e fundit të shtatorit e Latifi, pasi furnizoi me frysme kamerdaret e «robustës», i vuri kyçin derës kryesore të shkollës dhe po bëhej gati të nisej për qytet, kur në rrugën gjarpërore të fshatit dalloi një gaz që po i afrohej shkollës. Me shpejtësinë e një akrobati, e plandosi bicikletën në një qoshe, dhe, sa çel e mbyll sytë, hapi derën e shkollës.

Nga maqina zbriti një mesoburrë me çantë nën sqetull dhe më një çadër të mbështetur në njërin krah.

— Nuk e dija fshatin, por ata të rrethit më drejtuani. E kështu me të pyetur... Më pëlqeu inisiativa që kishit marrë dhe kjo më solli ta shoh në praktikë.

Latifi porsa ndëgjoi fjalën «inisiativë», u kujtua dhe foli:

— Po, po, si urdhëron, e hapëm... Kjo ishte edhe dëshira e tyre. Ju them të drejtën, ky është fshat arësimidashës dhe për këtë s'ke si qëndron indiferent.

— Sonte besoj... e mërkurë?

— Po, si urdhëron, e mërkurë tërë ditën. Nga ora katër e fillojmë mësimin. Kështu që...

«— Po ky q'do?!» — fliste me vete Latifi... — «Ne kemi detyrë ta hapim... Sa për frekuentim nuk përgjigjemi! Pse, more, do të shkojmë shtëpi më shtëpi t'i mbledhim?!. Jo, i dashur, s'kemi kohë të telpërt. Le tani që edhe jam fejuar, jo në xhiro, jo në film apo në ndonjë shfaqje.»

I porsaardhuri ndezi cigaren dhe hyri në korridorin e shkollës të njihet me agjuracionin figurativ, në pritje që të fillonte ora e mësimit. Kjo u bë shkas për mësuesin të manovrante. Nga larg dalloi Brahon, karrocierin e kooperativës bujqësore dhe i bëri zë.

Ja parashtroi situatën ashtu siç ishte dhe i ngarkoi detyrën.

- Shoku mësues? Këshitu grumbull, apo...
- Jo, jo cilindo që të hasësh.
- Pa dallim moshe?
- O-huu!.. Hapt së po bëhet vonë, po bie ora 4.
- S'ka rëndësi mosha:
 - Po grave dhe vajzave duhet t'u bëj zë?..
 - Aq më mirë...

Pastaj mori zilen e cjanit të Colit dhe e vërviti disa herë me ndërprerje.

Një grumbull fshatarësh gjithfarë moshash dhe seksesh ia bëhen te dera e shkollës dhe të habitur nga kjo e papritur shikonin njëri-tjetrin, sikur donin të gjenin shkakun e kësaj mbledhje. Mësuesi shikonte me vëmendje herë të deleguarin herë grumbullin e fshatarëve dhe, me lëvizje nga lart poshtë të kokës, i shoqëronte me buzëqeshje të lehtë dhe të ëmbël.

I deleguari shikonte me kërshëri atë grumbull fshatarësh. Ajo që e çuditit dhe e gëzoi, ishte masiviteti. Të vijë në klasën e pestë një pesëdhjetëvjeçar nuk është gjë e vogël... (Me këtë kishte parasysh një burrë të plakur me një palë mustaqe që i varesin vesh më vesh dhe që kishte zenë vend andej nga fundi i rreshtit).

— Hajde për dy, në vendet tuaja! — foli mësuesi duke ruajtur gjakftohtësinë.

Rrapushi (kështu quhej «nxënësi me mustaqe») përdrohdi dy anët e mustaqes dhe, porsa arriti pranë të deleguarit, përkuli trupin duke e përshëndetur me përzemërsi dhe u nis në drejtim të klasës.

— Në cilën klasë vazhdoni ju? — pyeti inspektori..

— Urdhëroni?!

— Cilën klasë vazhdoni sivjet, apo keni filluar sefte?..

Fshatari për një çast e humbi, se nuk dinte ç'ti përgjegjej porse, kur pa se inspektori po buzëqeshte, e mori veten, dhe, për të dalë nga situata foli:

— Në cilën të duash, mor ta marrsha! Po sot kam ardh për mbledhje! dhe në cilëndo klasë njësoj asht për mue.

PULA E SADIKUT DHE THATËSIRA

— He, çfarë na thua?..

— Si të të them, shoqja kryetare, shpresojmë dhe kurrgjë tjetër — dhe sytë i drejtoi larg në horizontin e pafund, ku dukej një re kuqaloshe.

— Duhet pa tjetër të gjendet rrugëdalja — foli e vrejtur kryetarja e kooperativës, duke vlerësuar situatën.

— E gjeta, shoqja kryetare! Jam i bindur se brenda dy a tri ditëve duhet të kemi shi.

— Flet me hamendje, apo?! —

— Jo, shoqja kryetare, me baza, dhe për këtë kam edhe faktë. Gruaja ime vuan nga përdhesi (kështu e quante reumatizmin) mirëpo, nuk di a më kupton, qysh mbrëmë s'është në terezi.

Kryetarja bëri buzën në gaz nga arësyetimi naiv i Tanushit, brigadierit të perimeve.

— U-ha! Të jetosh me shpresë, do të thotë të kapitullosh. Duhet gjetur rrugëdalje. Ne duhet të ve-projmë me goditje të përqëndruar!

— Ne, apo ato?! — iu përgjegj Tanushi dhe, me shprehjen «ato», kishte parasysh retë puplore që po pàrakalonin para tyre.

— Dita e diel, duhet shpallur ditë aksioni për ujitjen e bimëve bujqësore. Për këtë duhet të ftojmë dhe punonjësit e ndërmarrjes që na ka në patronazh dhe të gjithë së bashku të mposhtim situatën e krijuar nga thatësira.

— Ide gjeniale!.. Të lumtë, shoqja kryetare!

— Merri në telefon, 12-52 e kanë numrin dhe pastaj, sikur u çlirua nga diçka që i kishte zënë frymën, u ul në karrigen prej rrogozi.

— He, moj shoqe? Nuk përgjegjet!.. Po tanı?

— Lajmëro korrierin, t'i dalim punës përpëra. Vepro dhe mos prit urdhëra! O Nasuf!... Merre ku ta marrësh... Ku mbillet s'korret. E gjeta! Sadiku, edhe i papërtueshëm, edhe pelivan djalë. E kam timin. Me këtë rrugë më çon edhe radion për ta rregulluar në qytet.

...Sadiku, pasi mori instruksionet e rastit, u nis të nesërmen pér në qytet. Si gjithherë, i shtyrë nga «forçë e zakonit», mori me vete një shportë me vezë dhe një pulë pikaloshe. U sorollat tërë ditën pazarit dhe, kur filloj të errej, iu kujtua misioni urgjent që i kishin ngarkuar, por nata tashmë kishte rënë dhe llambat e neonit shndrisnin nëpér qytet. Zarfi, me letrën urgjente, i zhumbrosur në fundin e shportës, i kishte mbetur në dorë si dopio-gjashta.

«Po tanı si i bëhet?» Dhe, ndërsa fliste me vete, klientja e fundit i doli parasysh.

— Moj shoqe, a e shikon? — dhe, duke i treguar fundin e shportës, vazhdoi: — Të gjitha i shita. Eh, çfarë vezësh se! Ama pulë është edhe kjo që i bën! — Nga strajca nxori kokën e pikaloshes. — U bë vonë, se do ta kisha kripur. S'e di a më kupton?.. 21 lekë fundi i pazarit. I pafsh hajrin, se kam edhe

një letër urgjente e kam frikë se po më mbyllen zy-
rat. S'e di a më kuption?

Këtë fjalën e fundit e kishte pronë të tijën dhe-
e fuste vend e pa vend si levë bisede.

— Po ju kuptoju shumë mirë, more shok — foli
gruaja — po zyrat janë mbyllur me kohë. Kujt do-
t'ja çosh?..

— Vangjel Kronit!

— Drejtoret të ndërmarrjes, apo është tjeter?

— Pikës i ke rënë, nuk di a më kuption, dora ve-
të. Kemi lidhur krushqi, desha të thosha se ka në pa-
tronazh kooperativën tonë.

— Banojmë së bashku me një hyrje në pallat —
shtoi gruaja.

Ta marrsha... deshi të thoshte, po sikur iu duk
pa vend prandaj tha:

— Të lutem shumë, dorëzoja këtë letër. Të tje-
rat i ka të shkruara brenda. Urdhëro pulën pér 20
lekë, se e ke hallall, se u tregove shpëtimtarja e si-
tuatës.

— Sot është vonë, por po ia çoj nesër në mën-
gjez.

— Kur të duash — iu përgjegj Sadiku. — Ve-
tëm s'di a më kuption, është letër urgjente.

...Dita e diel nuk zbardhi si ditët e tjera në koo-
perativë. Qindra vullnetarë të pajisur me gjyma, ku-
sia, kova, e me enë të tjera uji, e thyen monotoninë
e fshatit.

Tanushi ishte në mes të sheshit dhe jepte këshi-
lla. Ndërsa maqinat parakalonin para tij, ai mburrej
pér organizimin e këtij aksioni, duke «harruar» ta
ndante hisen e «lavdisë» me kryetaren e kooperativës.

— A ju thashë, shoqja kryetare, se Sadikun e
kam mëqikun e brigadës.

— Ku është fjala? — ndërhyri në muhabet drejtori i ndërmarrjes, që sapo dridhte një cigare të qhuruar.

— Është fjala për Sadikun atë që ju solli letrën, e kemi pelivan.

— Posi jo. Pelivan dhe pelivan të madh bile. Po sot ku asht. Apo është lodh dje në pazar duke shitë pulën e tij dhe sot e ka shpallë pushim. Burkur fort besa. I lumtë kur di me e sjellë punën sipas leverdisë.

Kryetarja e Tanushi u shikuani sy në sy, të zenë me faj.

Maqinat venin e vinin duke sjellë vullnetarë, kurse Sadiku nga që kishte ndenjur vonë te kumara, s'po dukej ende. Rakia e kumbullave të sivjetshme i kishte përkundur një gjumë të ëmbël. Kushe-di, ndoshta shihte dhe ëndrra; shihte pazarin, vezët, pulën, sepse në fytyrë herë mbas here i ravizohej ndonjë e qeshur e lehtë.



Pula e Sadikut dhe thatësira.

BIÇIKLETA «MIFA»

Jo pa arësy, unë fle herët. Zakonisht dielli më gjen sipër timonit të skodës me rimorkio, duke përshkruar mijëra e mijëra kilometra nëpër rrugët e atdheut tonë.

Ndofta atë natë, që u prezantova me krevatin që në orën 8, i kisha bërë dy orë gjumë kur:

— Tahsim!.. Tahsim!.. — dhe kaq u desh që të shuhej grindja me ata të frigoriferit që po vononin të më shkarkonin dhe gjumi më doli.

— Hë, moj grua, çfarë ka ngjarë? Mos ndonjë e keqe?

— Ka ardhur Sefedini dhe kërkon që të takohet me ty.

— Sefedini?

— E po, baxhanaku, burri i Teutës, motrës sime.

— Të urdhërojë, moj grua, në shtëpi të vet është.

Nuk qe nevoja të më zgjonit.

— Vishu shpejt se nuk ka lezet. Rrallë vijnë, kanë ardhur së bashku me Teutën, dhe me ty kanë punë.

Turfullova se kisha arësy. Nervat m'u ngritën nga ata të frigoriferit që nuk më shkarkuan nëën-

dërr, dhe nuk përtojnë që, edhe zgjuar po të jesh, të të lënë tri-katër orë peng para derës së tyre. Vesha pizhamat dhe dola në kuzhinë.

— Ku je, more, dhëndërr — foli Teuta. — Të kemi si gur xhevahiri...

«E paskan një vezë, i thashë vetes.

— Si jeni? — fola shtruar. — Sa mirë bëtë këmbë e erdhët një herë. Po kaq vonë?!

— Pse ju flini pa rënë muzgu, ç'faj kemi ne?!

— Ndëgjo, Tahsim! Ju trazuam — foli Sefedini duke hyrë në temë. — I kemi rënë qytetit anembanë, meazallah se gjetëm gjë. E kemi fjalën për një bickletë «Mifa».

— Të kuqe — plotësoi e shoqja e Sefos, me një fjalë kunata ime e madhe.

— Biçikletë «Mifa»?!. Po ju shkoni te Luli në kinkaleri, ç'hyj unë në këtë mes?! Po patët gjë për transport, jam gati, për tjetër... çfarë të them?!

— O-huu!.. — vazhdoi Teuta — ne flasim dhe vesh s'merremi. Ju bridhni kudo, kështu që në ndonjë vrimë dyqani mos ka mbetur rrisku im. Amanetin e mban toka, e jo më njerëzit. Kështu që përmotrën e gruas e kisha për detyrë. Le që kush e qet me gruan, edhe po të duken shenja mospranimi. Por nuk qe e thënë të zotohesha unë, foli ajo:

— Ndëgjo burrë! Ja do t'ia sjellësh biçikletën motrës, ose mos thuaj se bën për gruan. Fundi i fundit, si ia bëre Teutës, si mua njëlloj është. Apo nuk e ke kunatën e madhe.

Kush ja prish gruas!.

— Shiko mirë, — porositi edhe një herë kunata, se ti ke punë edhe ndër magazina e mos e merr pa e kaluar fare në dyqan!

— Na fal! — foli Sefedini — se ju trazuam gjumin.

— E ka për detyrë — iu përgjegj gruaja, që më përfaqëson me mua, sikur unë të kisha mangut shqisën e të folurit. Pastaj shkëmbyem përqafimet, i uruan natën e mirë, pala jonë palës tjetër dhe u ndamë.

Mëngjezi zbardhi, dhe së bashku me kafenë gruaja nuk harroi ta përforconte amanetin, duke më futur në xhepin e brendshëm të xhaketës lëkure qesen e najlonit me lekët brenda.

Mendoni tani se çfarë detyre më binte; që në çdo qendër, e vogël apo e madhe qoftë, të ndaloja maqinën dhe t'i zija dyqanet me radhë.

— Keni biçikletë «Mifa»?..

— Vetëm një, edhe ajo është grashë.

— Urra!... — lëshova britmën si fëmijë e vogël, dhe një të përqafuar shitësen. — Ku je, moj shpëtimtare, se nuk të ka kush!..

Vetëm diferenca e viteve që na ndanin, u bënë barrikadë për çdo keqkuptim. Shitësja së pari dyshoi se mos... por, kur u qetësova, dhe fillova ta «fur-nizoja» me falënderime, atëherë besoi se kishte të bënte me një njeri normal.

Rruja e kthimit m'u duk më e shkurtër, dhe kjo e kishte arësyen e saj. Porsa arrita te apartamenti i baxhanakut fillova:

— Ty-tyy-tyyy!..

Teuta nga larg pa në karrocerinë e maqinës sipër thasëve të miellit, plaçkën e porositur, dhe për disa sekonda u ndodh në rrugë.

Biçikletën, para se ta grasatonte e lagëm me raki dhe meze të preqatitura nga dora e Teutës. Kjo skenë me pak përjashtime, u përsërit edhe në shtëpi, kur gruaja mori vesh realitetin.

... Që nga ajo ditë baxhanakun s'e pashë më. Edhe Teuta, që e kishte zakon të kthente shpesh, na harroi. Kur ja një ditë, pasi shkarkova ngarkesën, dhe ndërsa po kthehesha nga parku për në shtëpi, takoj Teutën sipër bicikletës, dhe njëzet metra larg, bashkëshortin e saj Sefedinin. Ajo që më bëri përshtypje ishte bicikleta, aq shumë e kërkuar prej saj. Ngjyra, nga e kuqja, ishte kthyer në lara-lara. Drita i mungonte. Stopave as që u shihej boja, le pastaj edhe rrjeta, dinamo, zilja... Kunata stopoi me të dyja këmbët, që përkohësisht i adoptoi ndër frenat.

— Po hë, moj kunatë? — fola unë pa u përshëndetur. — Si qenka katandisur bicikleta e re në këtë mënyrë?! Po sikur nuk ka as tre muaj që e kblerë?!

Ajo bëri buzën në gaz, kurse Sefedini, që sapo u bashkua me ne, foli:

— Nuk është e jona, e kemi marrë me qira, në kooperativën e bicikletave.

— Me qira?!



Bicikleta «Mifa»

— Ç'ka pér t'u çuditur? Teuta nuk ka mësuar ende ta ngasë mirë biçikletën, kështu që, deri sa ta mësojë i duhet një biçikletë, me të cilën mund të rrëzohet, të përplaset pa frikë. Pér këtë u detyruam të merrnim një biçikletë me qira që të praktikohet.

— Ashtu!?. Kur ke mashën pse të djegësh dorën i thonë kësaj pune. Po s'është e ndershme se shteti i ka vënë këto biçikleta pér të na ardhur nëndihmë dhe jo pér t'i shpërdoruar në këtë mënyrë.

REFERATI

— Jemi në tym! — tha drejtori, porsa vuri këmbën te dera e sallës së mbledhjes së këshillit pedagogjik. — Koha nuk pret! Brenda muajit do të zhvillohet konferenca pedagogjike dhe materialet duhet të jenë gati deri më 15. Edhe ju, shoku Tomorr, mos e bëni veshin shurdhër, por përvishuni referatit tuaj.

— Referatit?.. — dhe me vete shtova: «Si t'ia filloj!» Kurse drejtori, sikur deshi të më ndihmonte, foli:

— Temën jua kemi dhënë që para dy muajve. «Tomorr, i thashë vetes, do të vijë prapë fushata e abonimeve, i pari njeri që do të abonohet më tepër do të jesh ti. Vetëm «Sporti» nuk nxjerr gjë në dritë. Abonohu, o qyqar, në organet e tjera. Po t'i kisha koleksionet e «Mësuesit» dhe «Arësimit popullor», do ta kisha vënë festen mbi sy.

Edhe oreksi, prej të cilit nuk qahem, sikur më kishte braktisur. Humorit, që e kam shok të ngushtë, 'kësaj radhe nuk i dhashë shkas që të më joshte. Gruaja, kur më pa ashtu të merakosur, ma priti:

- Po ju sikur e fituat ndeshjen dje?
- Lemë, grua! Se është «tjetër ndeshje».
- Me cilin e keni?

— Me referatin — ia preva unë. Kurse ajo si për inat vazhdoi:

— A është skuadër e fortë?

— O-huu, ku më vret mua dhe ku e ke mendjen ti, moj grua! Gjithnjë nuk do të merrem me muhabete sporti, njeriu ka edhe halle pune. Kush thua se mund të më ndihmojë për një referat?

— Selimi...

— Të lumtë, grua! — thashë i gjëzuar. — Selimi do të më shpëtojë nga situata, i re pikës! — dhe që të nesërmen u ndodha tek ai se, që ta dini edhe ju, Selimi është shoku i ngushtë i fëminisë, i cili si edhe unë kryen detyrën e arësimtarit.

— Ku je, Selim — i thashë. — Do ta shpëtosh vëllanë tënd, se është në siklet.

Ai çakërriti sytë, sikur unë mos t'i flisja gjuhën e të parëve tanë.

— Si është puna?

Unë përsërita verbalisht kërkesën time, dhe u hodha në pritje të përgjegjes së tij.

— Cila është tema që ke për të preqatitur?

I tregova temën e i qava hallin. Dhe, t'ju them të drejtën, pa kaluar as dy-tri ditë, Selimi ma bëri çajren. Referati «Mbi prejardhjen e elefantit dhe vlerat ekonomike të tij», afronte tepër me një referat, që kishte mbajtur ai para dy vjetësh mbi gamilen, vendin dhe mënyrën e jetesës së saj.

Dita e shënuar erdhi, dhe në një nga sallat më të mëdha të shkollës sonë të zbukuruar për këtë qëllim, kishin zënë vend mësues të shkollave të tjera, inspektorë të ardhur nga seksioni dhe të ftuar të tjerrë. Referatin e huajtura e kisha shtypur në dy kopje dhe me ato mundësi që disponoj, u mundova t'i jepja sensin e duhur.



Referati

— Tri-katër të kollitura nga rrufa, që më kishte zënë kohët e fundit, ishin të vetmet ndërprerje që iu bënë referatit e pastaj e thava fundin e gotës së ujit, të vënë posaçërisht në dispozicion të referuesve dhe, duke e shoqëruar sallën me sy, bëra të ulesha.

— Ka kush ndonjë pyetje? — foli njëri nga ata të presidiumit.

— Po si jo — foli një shoqe, që u ngrit andej nga fundi i sallës. — Kjo i shërben punës sonë. Për të arritur rezultate sa më të mira, ne duhet kryesisht të punojmë me forcat tona, dhe nuk duhet të gatuajmë me miell hua. Apo keni ndonjë kundërshtim, shoku Tomorr?..

Të pranishmit më shikuan mua dhe kërkonin sqarim. Unë ngrita supet meqë nuk kisha se çfarë të thosha. Kurse shoqja vazhdonte: «për të pregetitur

një referat a punim shkencor, duhet të studojmë sistematikisht, dhe çdo gjë duhet ta lidhim me shembuj nga përvoja jonë si mësues».

Salla në heshtje i aprovoi fjalët e së panjohurës dhe që mua më ranë si dush. Pas dy ditësh takova shokun tim, Selimin. Ai më foli me mburrje të lligjshme për kolegen e tij të shkollës, e cila nuk u kusonte të ma jepte dushin e ftohtë, dhe që pas asaj dite më bëri të zeja mend.

E K S P O Z I T A

Ajo që fliste, ishte një vajzë që nuk i kishte kaluar të njëzetat, kurse ne që ndëgjonim ndryshonim nga njëri-tjetri si nga mosha, ashtu dhe nga seksi. Ajo fliste që ne ta ndëgjonim, dhe neve natyrish s'na mbetej tjetër vecse të hapnim veshët dhe sipas mundësive e aftësive ta kuptonim.

Ajo tha:

— E shikoni këtë, çfarë është?..

Një grua me trup të bëshëm, që kishte zënë vend para vizitorëve, foli:

— Raft për libra!

— Po tani... (dhe me lëvizje të shpejtë të duarve nxori nga poshtë një ndejse të mbuluar me damask gri me lule të kuqe).

— Divan — foli qimekuqi, që habinë e shoqëroi me ngritje vetullash dhe me një pasthirmë të shkronjës «a» të zgjatur nga prapa.

— Ja pra, e shikoni se ky objekt nuk kryen thjesht një funksion;

— Porse dy — e plotësoi qimekuqi, i gatshëm t'i vinte në ndihmë cicerones së ekspozitës.

— Ky pra është modeli «Dajti» i prodhuar nga artizanët e rrethit tonë.

— U lumtë! — thamë të gjithë njëherësh.

— U lumtë! — tha edhe shoqja ime dhe kësaj «u lumtë» vendosi siç duket t'i vinte përsipër 640 lekët që përfaqësonin çmimin.

Vizitorët, që përveç meje dhe gruas ishin të shumtë, lavdëruan edhe modelet e tjera që na i paraqiti ciceronia. Gjithcili simbas mënyrës së vet shprehu kënaqësinë dhe mburrjen e ligjshme, që edhe qyteti ynë nuk po rrinte prapa qyteteve të tjera në prodhimin e assortimenteve të reja.

— Hë, moj grua, si t'u duk ekspozita? — fola unë porsa dolëm te dera.

— Lëre, Simon, se ai divani ma bëri borxh, por sa të dalë në shitje, të rrah paret dhe ta sjell në shtëpi.

Që nga ajo ditë, sa herë dilnim në xhiro me gruan, bënim edhe një vizitë te dyqani i mobilerisë, për të parë se mos ishte furnizuar me divanë të tipit «Dajti». Shitësja, së bashku me buzëqeshjen e gjiltër na «furnizonte» me shprehje të njoitura «do të vijnë», «i presim», dhe pastaj u bënte reklamë divaneve të tipit «Drini» të cilat kishin mbushur 5-vjeçaritë për në dyqanin e mobilerisë, duke mos llögariutur kohën e dremitjes nëpër magazinat e NTSHAP-it.

Se kush e filloi i pari, po të më pyesësh, nuk di ta them, por di të them që me gruan na hyri grindje. Tema ishte kjo:

«Ku do ta vendosim divanin portativ, kur ta sjellim në shtëpi?»

Unë mendoja ta vinim në dhomën e gjumit, kurse ime shoqe ngulte këmbë ta vinim në kuzhinë.

Ajo e argumentonte propozimin e saj si më të favorshëm nga mundësítë për ta ekspozuar, sepse tani në stinën e dimrit aty hyjnë të gjithë vizitorët. Grindja kaloi në fazë interesante, kur hyri në Valle edhe vajza ime e cila mbante krahun e së emës. Objekti që po i shtohej shtëpisë sonë, ngaqë kishte sustë, do të luante edhe rolin e pelivanit, kështu që ajo edhe mund të argëtohej...

Si në formë dezhurni, vizitonim dyqanin e mobilerisë, po e njejtë skenë na dilte para.

— Hë?

— Në pritje...
Një ditë, dyqani ishte imbusur me klientë. Gjithcili shikonte i përqëndruar shitësen, që po fjalosej me një blerës.

— Ju i keni shitur nën dorë!
— Nuk është e vërtetë!
— Unë të sjell njeriun që i ka parë në dyqanin tuaj!

— Ku është fjala? — pyeta unë.
— Kanë dalë divanë portativë dhe kjo shoqja i paska shitur nën dorë, kujt ka dashur vetë.
— Moos!.. — foli gruaja, dhe fytyra e saj filloj të ndërronte ngjyrë, herë në të kuqe dhe herë në të zverdhur, si sinjalët e maqinave kur i hapin rrugë njëra-tjetrës.

— Duhet të kesh miq, o byrazer! — se kush foli nga fundi i blerësve.

— Këtu është shitje e lirë. S'pi ujë mikë — foli shitësja, kësaj herë e nevrikosur.

— S'ka pse të pijë! — iu përgjegj gruaja ime e papërmrbajtur. Tavernat kanë verë dhe raki mjaft, ç'ne uji!.. Apo s'është kështu?

— Ashtu është — dhe pas kësaj njëri qeshi, e gazi u pasua edhe nga të tjerët.

Blerësja, që pak para po fjalosej me shitësen, shikoi nga ne dhe foli:

— Ja ku është! — dhe gishtin tregues e solli ndër turinjtë tanë.

— Hë, moj Marte, se tani të patëm në gojë. I keni parë divanët më sytë tuaj? Më qafsh, folë, se plasa, kjo shoqja s'e pranon!

— I kam parë posa, bile kam qenë së bashku me burrin. Apo s'është kështu?

— Kush po ta mohon?

— Në dyqanin tim!? — foli shitësja duke i hapur sytë më tëpër se zakonisht.

— Në ekspozitën e modele të reja.

— O-huu!.. E po folë, të shkretën, se desh më mbjetën dhe, e ciliuar nga një ankth që i kishte zënë grykën, u mbush me frymë. — Ekspozita është ekspozitë, kurse dyqani është tjetër. Si kujtoni ju?!

Hane Shan, hane Bagdat!

JUSTIFIKIMI

Me gjithë masat e marra, ishte e treta herë që mësueses kujdestare të klasës së tetë i kishte dësh-tuar mbledhja prindër-nxënës. Jo se nuk u zhvillua porse, ngaqë nuk u arrit ajo që priste mësuesja. Afërditës i kishte mbetur peng. Mbledhjen e fundit e pre-gatiti mjaft mirë, duke dërguar edhe shkresë për secilin prind, bile vuri në shkresë edhe rendin e ditës. Por, si gjithënjë, të njëjtët prindër dhe për çudi në të njëjtat pozicione, zunë vend në klasën ku do të zhvillohej mbledhja.

Ata që vinin gjithnjë, ishin prindërit e atyre nxënësve që, si të thuash, ishin ajka e klasës si nga përparimi ashtu edhe nga disiplina.

— Cili është prindi i Nikollë Brokës? — pyeti mësuesja duke përfshirë klasën me sy.

Ne, të shpërndarë si «miza të bardha», shikuam njëri-tjetrin se kush do ti dilte zot atij emri aq të preferuar për mësuesen. Porse heshtja s'u prish.

— Po prindi i Agimit ka ardhur?.. — dhe sytë i i drejtoi te një meso burrë me trup të shkurtër, por të cilit i kishte prirë shëndeti, dhe siç duket ishte hera e parë që vinte, ngaqë nuk ma kishte zënë syri herët e tjera.

— Jo, nuk jam prindi i Agimit. Jam xhaxhaç i Fatmirës — foli i panjohuri. — Ngaqë prindërit e saj ishin në punë, erdha vetë — dhe ashtu siç u ngrit pa marrë leje, ashtu edhe u ul në vendin e tij.

— Po prindi i Zanës ka ardhur, apo mungon si gjithnjë?

E njëjtë skenë. Shkëmbim shikimesh, pastaj heshtje e plotë. Kur ja, u hap dera, dhe në klasë hyri një burrë i gjatë.

— Erdha të njihem, shoqja mësuese. Jam babai i Lipuçit. Kam dashur të vij tash sa kohë, që kur mbaroi filloren djali, porse hë sot hë nesër kam mbetur pa ardhur. Sot bëra çmos dhe ja... Si të të themi!?

— I kujt jeni?.. — foli mësuesja e nxituar, duke mos e kontrolluar shprehjen.

— Jam i Tush teneqexhiut. Babai më ka vdekur nga malarja këtu e tridhjetë vjet të shkuar. — Prindi i cilit nxënës jeni? — foli mësuesja, duke u shprehur më qartë.

— Jam babai i Lipuçit — dhe fjalën e fundit, që e shprehu në formë dëshire, ngaqë e pa se nuk u prit mirë, e shqiptoi me gjysmë zëri. Mësuesja, me gjithëse nuk e kuptoi se cilin nxënës përfaqësonte, e ftoi të ulej.

— Më falni, ju lutem!.. Kush ishte fëmija juaj? — pyeti përsëri mësuesja mysafirin e fundit, që sapo zuri vend në bangën e mesit.

— Babai i Filip Buzhalës!..

— Shumë mirë!.. — dhe me vete shtoi: «Aty më rri... më dole në shteg. Nuk ke nga të më ikësh.» — E dini se ju kam kërkuar kaq herë edhe në shtëpi? Bëtë shumë mirë që erdhët.

— E dini thoni?! Po mos tē ishte kështu, as që do tē më kishit parë. Ngaqë e pashë tē arësyeshme, bëra këmbë dhe érdha në shkollë.

— Me Filipin tuaj nuk i kemi punët mirë — vazhdoi mësuesja. — Mungon shpesh, disa herë ikën nga mësimi. Si t'ju them. ... Është shumë i padisiplinuar, pa le në mësime!

— E pamundur! Lipuci i padisiplinuar?!. Mos ka ndonjë keqkuptim? Shiko mos ma ke ngatërruar më ndonjë tjetër? T'ju them tē drejtën — vazhdoi të shprehej mysafiri i fundit — ai, domethënë djalili im, është krenaria e fisit tonë. Se ne, që ta dini ju, shoqja mësuese, dhe këta shokët e shoqet, që po u jepet rasti tē më ndëgjojnë, jemi gjak i ëmbël, edhe nga gjeneracioni i gruas meazallah se kanë nxjerrë ndonjë tē sertë, që t'ia prishë biografinë...

— Jo më larg se sot, bëri diçka që nuk i ka hije një nxenësi — vazhdoi mësuesja tē tregonte.

— Kishite marë një bretkosë dhe e kishite lidhur me një gjalmë e pastaj ashtu e vërtiste nëpër klasë para nxenësve si pa gjë tē keqe — tha mësuesja duke shtrirë shikimin nga ne që po ndiqnim me vëmendje këtë diskutim.

— Bretkosë?.. E pabesueshme!.. Që ta dini ju, shoqja mësuese, kjo që thoni ju nuk e përfaqëson realitetin. Së pari, do t'ju sqaroj se ajo nuk ka qenë bretkosë e gjallë, por një imitacion i saj. Kjo që thoni ju, ishte një lodër që ia kanë dhënë gruas në qendër tē punës si dhuratë pér Vitin e ri. Pastaj, c'është nevoja tē lidhet me gjalmë, kur fabrika i ka aplikuar çelësin pér ta kurdisur? A ka gjë tē keqe në këtë mes? Fëmija këtë nevojë edhe pér argëtim... Edhe ne, kur ishim tē vegjël, bënim lodra tē tilla.

Ne, që ishim në sallë, u shtangëm ngaqë na ra

e papritur mbrojtja që babai i Lipuçit i bënte të birit.

— Me lejë! — foli një grua që si duket edhe asaj i bëri përshtypje kjo skenë e papritur. — Djali juaj nuk i lë dy gurë bashkë dhe, me sa po shoh, paska të drejtë mësuesja. Qënkeni ju, ai që e paskeni prurë në këtë gradë. Unë, që ta dini — nă u drejtua neve që po e ndëgjonim — banoj në një pallat me shokun. Djali i tij është bërë problem edhe në lagje. Vetëm po ta shikoni hyrjen e shkallës sonë të zhgarravitur me qymyr të djegur nga djali i tij, do të gjykoni. Ja kemi vënë në dukje sa herë, porse ky ka bërë veshin të shurdhër.

— Ndëgjo, moj shoqe! — iu drejtua asaj me një të «prerë sëpatë». — E njihni Xhotin? Ose së paku keni dëgjuar për të? — dhe pastaj, me gjak-ffohtësinë që e karakterizonte, vazhdoi. — Ai ka qenë një piktor i përmendur... dhe që ta dini ju, karierën e tij e filloi duke piktuar bagëtinë me thëngjij të djegur në shkëmb! E si thoni ju? Të zhvillohet talenti u dashkan auditore dhe sella luksoze?! Në asnje mënyrë!.. Pastaj, ç'hyjnë muret këtu?! Ne kemi ardhur të pyesim si shkojnë fëmijët tanë në mësime, dhe secili të flasë për fëmijnë e tij dhe mos t'i fusë hundët në punët e tjetrit.

— Edukimi i fëmijëve është problem i të gjithëve — foli mësuesja e nxehur. — Kështu siç shprehuni ju, nuk luani rolin e një edukatori, por të një babai që ndikon shumë keq në edukimin e fëmijës.

— Ju dukérka vetja si babai i «Xhotit»! — foli me ironi një burrë i gjatë, andej nga mesi i bangave.

— Mblidhe, more mendjen, sa s'është vonë! —
shtoi një plak andej nga fundi i klasës.

Burri i gjatë shikonte sa para prapa. Breshëria e qortimëve që vinin nga të katër anët e shkundën. Filluan ta mbysnin djersët. Mbledhja e klasës, ndonjëse filloi me fllad, mbaroi me furtunë. Kjo furtunë, burrit të gjatë, që kishte vite pa shkelur në prakun e shkollës, iu duk uragan i vërtetë.



«ADMINISTRATORI» I FAMILJES

«Puna është nder» — u thoshte Marku miqve që kishin ardhur për t'i pirë kafen e të birit, që në ato ditë ishte fejuar. «Kush punon edhe gëzon». Këto fjalë nuk po i shpik nga mendja, janë fjalë të provuara e të trashëguara nga të parët tanë.»

Për t'i dhënë rëndësi muhabetit të tij, përdridhëtë dy anët e mustaqeve që i vareshin vesh nië vesh dhe i lëvizte qepallat e syve sikur donte të aprovonte fjalët e tij.

— A e dini, more burra, sa bukur kishte folur Naim Frashëri?..

— Folë, bre burrë, mos ta preftë kush fjalën!

— «Punë, punë natë e ditë, që të shohim pakëz drithë». Ka qenë patriot i vendit tonë...»

— Besa, edhe shkrimtar me vlerë — shtoi një djalosh me kominoshe tërë vaj.

— Pa punë nuk jetohet, ajo ta bën jetën më të gëzuar. Kështu more burra, ndëgjoni plakun çfarë ju thotë.

Ky Marku nuk i kishte mbushur as të pesë-dhjetat, por moshën e kishte rritur.

Kur e pyesnin «sa vjeç je?», nuk tregonte të
vërtetë, dhe e përcillte muhabetin:

«Ohu, u plaka tani! Ua kemi lënë të rinjve!»..

* * *

— A e di, shoku Mark, se pleqtë e qytetit, me-
gjithëse kanë dalë në pension, kanë shfaqur dëshi-
rën të punojnë disa orë në ditë?

— U lumtë! Ashtu duhet! Hajt, pra, çojeni rre-
thazi! Mirë se keni ardhur!..

— A ma ndëgjoni edhe një fjalë? Edhe unë
nuk do të dorëzohem, megjithëse i kam dysh-
dhjetë rob nën vete.

— Jo more! Ç'po na thua kështu?!

— A janë shumë pér gji prej tyre?!

— Mos folë marrëzira, more Selman. Më i vogli
e ka marrë pasaportën.

— E çuditshme! E megjithatë janë robtë e tu?..

— E po delet kanë nevojë pér çoban. Apo
s'është kështu?.. Folni, more burra!..

* * *

Llogaritari i kooperativës bujqësore po ndante-
lekët e ditëve të punës.

Kooperativistët prisin të hynin brenda, kur-
t'u delte emri.

— A jeni, burra?

— Mirë se erdhe, Mark Zagani! A u lodhe?..

— Si pleqtë e si koha...

— Sikur tē ecte koha si ti, vaj medet halli! — ia priti një burrë thatanik, që dukej se ishte moshtatar me Markun e megjithatë hidhte nga tridhjetë e pesë norma çdo muaji.

— E po kështu i thonë një fjale.

— I kanë pasë thënë dikur, se sot koha nuk ecën, por fluturon... Apo s'po flas si duhet?


— Të lumtë goja, se ashtu si fole është! — u përgjegj dikush.

— Unë! — u përgjegj Marku i cili ndëgjoi emrin e njerit prej pjesëtarëve të familjes së tij dhe nxori nga xhepi kuletën e lidhur me gjalmë lëkure rrëth e qark.

— Marije Zagani!

— Unë! — foli përsëri Marku.

— File Zagani!



Administratori i familjes

— Unë!

Dhe, ndërsa llogaritari vazhdonte të thërriste emra me të njëjtin mbiemër, Marku vazhdonte të përgjegjej me zë të trashë: «unë». Pasi mori lapsin kopiativ që ishte mbi tryezë dhe pasi e lagu me pështymë, zhgaraviti në disa vende borderonë me firmën e pakuptueshme të tij.

— Me zemër të mirë! — tha si pa të keq llogaritari.

— Të lumtë goja! — u përgjegj Marku

— Të lumshin krahët!.. — shtoi dikush tjetër me ironi.

— Edhe ty! — u përgjegj Marku me mendjen te shpotitë e shokëve, dhe për çudi këmbët s'e shpune të klubit i fshatit siç e kish bërë zakon, por në shtëni.

E DO ZAKONI...

Sivjet prodhimi i domates qe i mbarë në kooperativën tonë. Gruaja ime, që ësht brigadiere e përimeve, nuk e mban mend prej vitesh një prodhim të tillë. Edhe mua, së bashku me kooperativistët e tjerë, më bëhet zemra mal, kur shohim se kooperativa jonë ka suksese. Ky është edhe shkaku që të gjithë verën e shkuar çdo ditë kam zbritur në qytet me karrocën e madhe për të dorëzuar domatet në fabrikën e salcës.

— Kur do të më shkarkosh mua? — i thashë Markut, magazinierit të fabrikës. Kisha më se dy orë që ia kisha zënë derën... me karrocë.

— Ndëgjo këtu, kapelan! — foli ai duke shkelur me këmbë cigaren. — Do të shkosh te magazina numër 3 në rrugën karshi spitalit!

— Pse more, keni hapur ndonjë fabrikë të re? — po nuk mora përgjegje se një person tjetër filloj bisedën me magazinierin.

«O burra! Edhe një herë ktheje karrocën andej nga erdhe»!

— A di gjë ku ka magazinë domatesh? — pyeta një kalimtar.

— Në fund të kësaj rrugice — dhe me sy më dha drejtimin.

Bëra kthesën dhe nga asfalti hyra në një rrugicë me dredha, ku arkat e domateve po «lundronin» në një det të dallgëzuar.

Një shtëpi dykatëshe. Më tej një shesh dhe pranë tij një derë oborri me harqe prej guri të skalitur. Një burrë me kostum térital, me një krvatë në bojë të dheut, që ia ndante krahërorin në dy pjesë të barabarta, kishte zënë vend te hyrja e saj.

— Qofshi vetë! Ju pastë lënë nafakën! — foli njëri.

— Mos u mërzitni, se kush ka lindur edhe do të vdesë — foli një i dytë — por shqyr e ka lënë shtëpinë plot!

— Ngushëlloje babanë! — foli edhe një tjetër.
— Nuk munda të vija atëherë kur duhej, kështu që erdha sot.

— More shok! — fola unë. — Më falni se... Kur, ç'të shikoj! Një fytyrë e zeshkët më doli para. Dy sy të njojur u ndeshën në shikimin tim. — Palushi! Për fjalë të nderit Palushi! — Po ku je, more? — shtova unë duke dashur t'i jepja ngjyrë humorë, por kur m'u kujtuan fjalët ngushulluese të atyre që sapo u larguan, u përmbytja. Që ta merrni vesh me Palushin kemi bërë ushtrinë, dhe miqësia e lidhur në këto raste nuk harrohet. Edhe vjet, kur solla domatet, e kërkova, por s'e takova dot, dhe ja sot krejt papritur u takuan.

— Po ku je, që nuk kam lënë njeri pa pyetur për ty. Ku takoi të shihemi sot që... — dhe pa dashur nxora një ofshamë pikëllimi.

— Më ka vdekur gjyshi — foli ai sikur të desh të më qetësonte.

— Po çfarë pat? Vuajti, apo...

Gripi i vjetshëm e këputi.

— Vjet! — fola unë si i çuditur, nga kjo përgjegje e papritur. — Po tani ç'hyn?!

— Ka mbetur zakon që në krye të vitit të parë vijnë të afërmit dhe dashamirët për të të hequr mërzinë.

— E po duhen harruar këto zakone. Ne jemi fshatarë dhe disa gjëra i kemi zhdukur.

— Edhe po të duam t'i harrrojmë, kush të lë?, i shikón!? — foli Palushi duke hedhur shikimin nga hyrja e shtëpisë së tij ku nga shkallët e gurta po zbrisnin tre-katër vetë, që pasi ishin nderuar me kafe dhe me raki, ashtu siç e lypte zakoni, po thithnin me èndje cigaret me filtër, duke nxjerrë shtëllunga tymi pas përfundimit të kësaj «ceremonie.»

— Të kishe mbyllë derën e të kishe shkue diku, se vetëm këshfu zenë mend.

— Këshfu u duhet ba — por nuk e vazhduam më tej bisedën u ndamë me njjeri tjetrin mbasi na qenë afruar ata të tjerët që i dhanë fund vizitës së tyre.

«SEMUNDJE» ME SHERIM

— Po ti, moj lule?! Me gjithë mend apo?.. Si
është halli yt!? Kujton se je ende vajzë?! Mblidhe
mendjen, se u bëre nënë dy fëmijësh! Unë mendova
se u regjistrove sa për të kaluar radhën, kurse ti
dashkë të marrësh flamurin. Kush do ta pregatisë
darkën?.. Po fëmijëve kush do t'u vijë rrëth? Ndih-
ma që më takon të jap mua si burrë, nuk është të
kthehem në dodo fëmijësh. E për çfarë se?! Se
gruaja do të na bëhet e dijshme! «Iku vapa me
gusht» Sado që të mundohesh, zor se do të nxjerrësh
gjë në dritë.

— Ku e ke fjalën? — iu përgjegj Marija të
shoqit, kur e pa aq të nervozuar.

— Edhe pyet!.. Po ku është parë kjo? Nuk të
mjafton dita që je larg shtëpie, porse edhe natën.
U bëre gazi i botës, e duhet të dish se gjithshka
rëndon mbi mue, derisa mban mbiemrin tim.

— Për ku e ke fjalën, mor burrë?... Folë më qar-
të, ç'të ka shkrepur sonte?

«Ke të drejtë, moj grua, ke të drejtë!» — i pat
thënë edhe pylli sépatës: — «Bjerë sépatë, bjerë, se
unë ta dhashë bishtin» — e me zë tha:



— Nuk tē mjaftoi që hyre nē punë, po tani u dashka tē vazhdosh edhe shkollën!.. Se mos do tē bëhesh drejtoreshë e uzinës. Ka kush bëhet, po tē jetë nevoja. Mua gati më firuan..., edhe kjo! ... Qysh sot nuk do tē shkelësh as prakun e shkollës! Pastaj si mund ta vazhdojë shkollën një e sëmurë? Hë de, folë!

— E sëmurë??!

— Pse çuditesh? Sëmundjet për njerëzit janë. A tē dhemb koka? Marrje mendësh po e po, këto janë shenja tensioni. Të lartë bile.

— Tensioni??!

— E moj, pse habitesh! Këtë sëmundje e keni edhe për röd. Vjet a tē vdiq halla prej tensionit?

— Halla vdiq 80 vjeçe.

— Nuk ia shikuam letërnjoftimin kur mbylli sytë. Ndëgjo mirë çfarë po të them. Sapo u ktheva nga shkolla, bisedova edhe me drejtorin. Natyrisht, kur ia parashtrova arësyen, më premtoi.

— Për çfarë?

— Të të përjashtojë nga shkolla me mirëkuptim. Arësimi i mesmë nuk është i detyruar.

— Shkolla është bërë kërkesë e kohës, mor burrë. A e di ti se një ndër kushtet për t'u ngritur në kategori është edhe vazhdimi i shkollës?

— Ende nuk ke ndenjur dhjetë vjet me të njëjtën kategori?! Pale-pale!.. Hajde vishu! Kot e hoqe pallton.

— Ku të shkojmë?!

— Edhe pyet! Fola një herë!.. Një e sëmurë me tension s'ka si ta vazhdojë shkollën.

— Çfarë tensioni, mor burrë?.. Mos folë marrëzira! Unë jam shëndoshë si molla. Po të ketë njeriu një dhembje koke për dy, a tri ditë, nuk do të thotë se vuan nga tensioni. Kollaj fort, mund të ketë qenë një grip dhe kurrgjë tjetër. Goxha grua, mos të them të vërtetën është turp.

— Nga nevoja. Këtë e lejon edhe edukata e miresjelljes. Ndërsa thithë cigaren me filtër, i dha edhe këshillat e fundit, duke i përcaktuar shenjat e diagnozës: — Marrje mendësh, këputje gjunjësh... të tjerat i di yetë. Hë, edhe tensioni më shkon deri në 200.

— Ndëgjo burrë...

— S'kam çfarë të ndëgjoj, u bë sa kohë me këto avaze.

— Më mirë të mos isha regjistruar fare.

— Për tu regjistruar ishte fushatë për të gjithë, pastaj i mençuri i bën bisht, në një mënyrë o në një tjeter.

Filipi, duke mos ia hequr krahun së shoqes, gjatë rrugës për në shkollë, pëershëndeste të njojurit, ndërsa e shoqja mendonte si të vepronte që mos ta linte shkollën.

Arritën te dera e shkollës, as edhe një fjalë nuk shkëmbyen me njëri-tjetrin. Ndërsa po ngjishnin shkallët, burri foli:

— Ato çfarë të thashë në shtëpi, nuk është nevoja të t'i përsëris. «Zakonisht, kur ndërron klima, kam shqetësim më të madh».

Një krismë e lehtë, një buzëqeshje ironike dhe një lëvizje automatike e kokës nga lart poshtë, të gjitha këto së bashku të shoqëruara me «një mirë mbërëma» ishin hyrja.

— Hë, moj Marija?.. Po ju sikur e morët me qejf? Se q'më tha burri!..

— Si urdhëron, shoku drejtor, e mbyti hipertensioni.

— Kur ju ka filluar?

— Ka nja tre muaj.

— Të flasë vetë, gojën me vete e ka!

Filipi përsëriti buzëqeshjen e minutave të para, bëri pak prapa dhe, duke i bërë shënjën «vazhdo» së shoqes, hodhi shikimin nga drejtori sikur në ftyrën e tij deshi të gjente aprovin.

Gruaja përsëriti mekanikisht: «Ka nja tre muaj» dhe pastaj vuri buzën në gaz.

— Po kështu çfarë shqetësimi ndjen? Sa ju shkon tensioni?..

— Sa the, burrë, shkon?

— Mua, jo, moj dreq, por ty! — foli Filipi sikur ta pickonte gjarpéri.

— Po, more burrë, mua, po sa duhet tē them... — dhe përsëri buzëqeshi. Kësaj radhe vuri nē dyshim thënien e saj.

— Nuk po kuptoj një gjë — foli drejtori i shkollës që po dyshonte — kush ka tension: Ju apo ju?!

— Si tē tē them, shoku drejtor — foli Marija. — Tensioni qenka sëmundje e keqe. Mjerë atë që zënkë! Për këtë, mund t'ju flasë edhe burri — dhe sytë i drejtoi nga Filipi që, i ndezur nē fytyrë, sa s'pëlciste. — Edhe këtij se ku iu shfaq kjo sëmundje, që nganë shtatori i vitit tē kaluar. Kurse mua m'u shfaq pak kohë para se tē vija këtu. Kështu është, burrë?..

— Ashtu është — foli drejtori, që tashmë hyri nē temë. — Kjo është me tē vërtetë sëmundje e dëmshme.

— Jo, shoku drejtor, unë nuk kam kundërshtim që Marija ta vazhdojë shkollën — mezi priti Filipi tē shfajësohej. — Për mua që sot, ashtu siç ka ardhur vazhdimisht, tē vijë nē shkollë. Porse — iu drejtua së shoqes. — Po tē dhembti koka, si do ta bësh?

— Do tē mundohem ta largoj me aspirina apo fenaskona, e besoj që do tē më largohet...

Drejtori qeshi. Marija shikoi inga dritarja përtë larguar gazin, por nuk mundi. Qeshi edhe ajo. Kurse Filipi, duke mos gjetur rrugëdalje tjetër, pranoi tē dorëzohej.

KONFLIKTI

Të rrahurat e shuplakave lajmëruan se mbledhjes i erdhi fundi dhe, kur drejtuesit e saj po bëhen gati t'u linin lamtumirën fronave të gjelbër, se kush më thirri me emër përkëdhelës, emër që më takon ta ndëgjoj vetëm atëherë, kur shoqërohet nga prapa më shprehjen «Ta kam mësye për nji nder».

— E patë gjëkundi Fikun, apo jo?.. — u ndëgjua edhe një herë. Ai që foli ishte koka drejtuese e ndërmarrjes sonë. Duke e shoqëruar sallën me sy, më kërkonte mua, që isha ekonomati, magazinieri, furnitori dhe njëkohësisht përgjegjësi për aktivitetin kultural të ndërmarrjes.

— Urdhëro, shoku drejtor! — fola unë dhe sytë e mi u ndeshën me të tijtë. — E dini se çfarë kemi me datën njëzet?..

— Si urdhëron, shoku drejtor! — dhe me vëte po vrissja mendjen se çfarë shëhontë kjo datë! Ajo që më erdhi tider mënd ishtë dita e rrogave. Por ja, rrugat s'merren me këtë datë. Kurse drejtori, duke hyrë në temë ma sqaroi këtë ehangjel!

— Më datën 20 të muajit të ardhshëm do të zhvillohet olimpiada teatrale e qendrave të punës,

kështu që edhe ndërmarrja jonë do të konkurojë.

— Me çfarë pjesë do të dalim ne? — shtova unë, kurse ai u përgjegj:

— Pyetje është kjo?!. Kur ta gjej unë pjesën ç'të imbetet ty si regjizor?

Unë desha të flisja po, kur drejtori më vuri titullin «regjizor», preferova heshtjen. «Mbahu, i thashë vetes, nuk ke nga ikën!..»

— Shoku drejtor, kur të vijë koha për t'i dhënë lustër, do të vijë kush të na ndihmojë?..

— Në qoftë se nuk do të arrijmë, mund t'i bëjmë edhe me bojë vaji — foli ai, duke e patur mendjen te skenat. Kurse unë sqarova:

— Para se të dalim për të konkuruar, kemi nevojë të na vijë në ndihmë ndonjë nga ata të teatrit profesionist?

— Po si jo, që nesër!.. Edhe çereku i trupës së teatrit po të të duhet, t'i sjell lala ty. Për këtë më është zotuar drejtori i teatrit. — Dhe pastaj, duke më dhënë buzëqeshjen e tij të zakonshme, hyri në mes të atyre që ishin në gatishmëri të plotë ta shoqëronin deri te hyrja e apartamentit të tij.

«Po tanë?.. E, more Tefik, i thashë vetes, si i dolle zot kësaj pune, që s'ta kanë pas zanat as gjyshërit as edhe stërgjyshërit!»

Këmbë-këmbë u ndodha te biblioteka e qytetit, dhe ngadalë po u ngjitesha shkallëve të gurta...

— Moj shoqe, kam ardhur të më rekomandosh ndonjë pjesë teatrale për ta vënë në skenë në ndërmarrje.

— Komedi apo dramë?..

— Sido që të jetë, moj shoqe, porse mundësishtrimos të ketë shumë personazhe.

Ajo, për t'i dalë lakut, solli një grumbull revis-tash të pashfletuara dhe i hodhi në tryezë. — Urdhë-ro e zgjidh!..

Cilin të lexoja më parë?!. S'kisha haber. Atëhe-re ndoqa rregullin: kush ishte më e varfër në personazhe, ajo do të kishte fatin ta shihte skenën.

* * *

Pjesa qëndroi dy javë në sirtarin e tryezës së nëndrejtorit të ndërmarrjes që ishte ngarkuar për aprovimin e saj, dhe pastaj fillova nga puna.

Ishim duke u hyrë roleve, dhe provat po vazhdonin në rregull, kur te dera e këndit të kuq hyri një meso burrë, që nga pamja e jashtme nuk i kish-te kaluar të dyzetat. Ndërsa po bëhesha gati t'i tre-gaja derën nga erdhi, si duke buzëqeshur foli:

— Si ju shkojnë provat? Cilën pjesë keni zgjedhur?.. dhe, pasi hoqi pallton e zezë, duke e palosur në prehër, vazhdoi: — Keni hasur vështirësi?..

Atëhere u kujtova se me cilin kisha të bëja. U gëzova, kur mendova se pjesës po i vinte dorë një njeri i kualifikuar.

— Kush luan rolin e inxhinierit? — foli ai porsa e njoha me pjesën, dhe filloi nga ato që në gjuhën profesionale quhen Mizanskena.

«Inxhinierin» nga ndenja që e kisha vendosur unë, e ngriti në këmbë. «Fluturën», nga skena e nxori në paraskenë. Kurse roleve të dorës së dytë u dha goditjet e nevojshme sipas tij. Pastaj buzëqeshi, na uroi punë të mbarë dhe natë të mirë, dhe, duke u zotëruar se do të vinte prapë, u zhduk pas arkave të ambalazhit, që zinin hyrjen e derës së këndit të kuq

dhe që «përkohësisht» prëheshin aty si para tre vjetësh. Unë fillova nga restaurimi i atyre që m'u këhilluan nga i «kualifikuar» dhe, pasi i porosità aktorët për respektimin e orarit të provave, u shpërndamë për t'u mblëdhur përsëri të nesërmen në mbrëmje.

... Ishin ditët e fundit të provave. Kisha filluar nga përsëritja.

— More shok, ku janë ata që bëjnë prova estrade?

— Teatri — korrígjóva unë dhe 'parafolësi vazhdoi:

— Jam i ngarkuar t'i vij në ndihmë grupit túaj.

— Ky që fliste, ishte një hollak me hundë të kërrusur dhe me një pallto bojë mishi.

— Ne jemi — shtova unë e, për ta njojur më mirë, e ftova të ulej dhe vazhdova provat.

— Në asnjë mënyrë «inxhinerin» më këmbë — ndërhyri regjizori i «ri», dhe vetë u çua më këmbë. Ai duhet patjetër të qendrojë ndenjur! Bile, duhet t'i vejë duart në kokë si i preokupuar.

...Po ju, mój shoqe? — iu drejtua «Fluturës. — Pse këtu në paraskenë?! Futu sa më brenda sfondit!..

Pasi edhe ky bëri korigjimet e rastit, na u zotua për gatishmëri e ndihmë deri në momentin e fundit të shfaqjes dhe, duke mos harruar të na përshëndeste të gjithë, na la hijen...

Edhe tri ditë na ndanin nga dita e konkurimit. Unë mundohesha të gjeja të «mesmen proporcionale» ndërmjet dy regjizoreve të «gatshëm» për të na ndihmuar, dhe kisha vendosur që të niesërmën ta organiza jo shfaqjen e pjesës para punonjësve. Kur ja, të këndi i kuq hyri drëjtori më një burrë që mbante

syze të zeza, të cilat nuk i hoqi edhe kur hyri brenda.

— Si dukeni?.. U pregatitët?..

— Si të të them, shoku drejtësor — shtova unë.

— Ky shoku punon në teatër dhe ka ardhur të na japë ndihmë.

Kanë ardhur edhe dy të tjera si ky — fola unë.

— E po të thashë, more Tefik, se edhe çereku i trupës profesioniste po të na duhet, drejtori i teatrit është i gatshëm të na përgjegjet.

Fillova provat. Burri me syze të zeza nuk fliste, por me stilolaps mbushte fletët e bardha të blokut me kopertinë të kuqe. Ngandonjëherë shkëmbente fjalë me drejtorin, i cili i vrejtur dhe me seriozitet po e ndiqte pjesën.

Vërejtjet na i dha me shkrim, se si duket edhe ky nuk ia kishte ngenë.

Dita e konkurrimit erdhi. Grupi teatral i ndërmarrjes sonë u paraqit me dramën «Konflikti» të një shkrimtari suedez. Dhe me të vërtetë, porsa u hap sipari, ra në sy konflikti.

Së pari kjo u duk në lojën e aktorëve, të cilët interperetonin rolet e tyre, sipas orientimeve të dhëna nga regjisorët e ndryshëm. Së dyti konflikt pati edhe në mes të anëtarëve të zhurisë, të cilët përbëhen nga «treshja regjizoriale» që na dha «ndihmën e duhur». Pritej që të krijohej konflikti edhe në mes personazheve të shkruara nga autor, por kjo nuk u arrit.

LABORANTJA

— Unë një, Nasufi dy edhe një tjetër, emri i të cilisit nuk po më kujtohet, ishim dëshmitarë.

— E çuditshme!?

— Aspak!

— Çudi! Kur vinte në verë për pushime, nuk flijtej me të nga mendjemadhësia.

— E po kështu ulet hunda.

— Se mos ka pasur se për çfarë ta ngrejë. Po ta marrësh drejt, den-babaden ato kanë qenë askushi.

— Të të them të drejtën, Luto, për këtë që po më thua po më bëhet qejfi. «Kam shkollë unë». Mbaje, të rroftë, se për shkollen tënde nuk kemi nevojë. Më thuaj, për kokën tënde, a shkon shkolla në fshat? Haja, se një mësuese mund të na duhet, por këto zanatet e tjera ç'hyjnë këtu?

— Laborante!

— Pika më mirë! Edhe fytyrë për laborante ka!. Ku kemi laborator në fshat?! Edhe po të kemi, ç'na duhet?! Të analizosh mizat se nga e kanë origjinën?

— Po të duan që të jenë në rregull me barkologjinë, t'i shpërvjelin mëngët, përndryshe...

— Po të isha unë në vend të kryesisë, as muratore nuk do ta kisha futur, porse drejt e në bujqësi.

Edhe aty ku është, ka vend për tangërllek.

— Më qafsh, më trego edhe një herë se çfarë po bënte?

— Të thashë një herë, ishte kthyer në ndihmës-muratore. Mbante spangon, sillte gurë, llaç e tulla. Ajo pra është edhe delikate!

Kaq u desh dhe fjala mori dhenë.

— Jo vetëm që e kanë përjashtuar nga shkolla, por edhe motivacioni i është dhënë që «vaj medet». Çështje morali — shtoi Prendi.

— Po mirë! — foli një grua duke shprehur habi. — Si është e mundur që vajza e filanit... të shkasë?

— Të shkasë? Dhe me të dyja këmbët bile!..


— Po sikur sivjet kishte klasën e fundit! — foli një burrë i shëndoshë, që mezi e nxinin kominoshet e dokut trupin e tij si brumë të ardhur.

— Vdekja kapak floriri — foli një tjetër, që e freskonte bisedën me proverba.

— S'keni punë tjetër, që merrni në gojë të tjerët, mor të uruar. Ky që foli ishte një burrë me nofulla të dala që, sikur u komentua kur ai u largua, kishte lidhje gjaku me të.

...Brigada e muratorëve kishte përfunduar ngrijtjen e xokolaturës së gurit dhe muri i tullës me ndihmën e kolektivit po merrte shtat. Zana, e veshur me pantallona dhe me shaminë shumëngjyrëshe në kokë, i jepte tulla silikate njërit prej ustallarëve, që i vendoste në kolonë për një.

— Ja — foli Lutura me triumf, duke bërë shenjë me gishtin tregues. — Shikojeni, se unë nuk flas kurrrë kot për tjetrin, qoftë edhe një fjalë të vetime. Singjeritetin e trashëgoj që nga stërgjyshërit, e denbabaden.



— Puna e mbarë! (Ky ishte kapari sa pér të hyrë në temë).

— Mbarë paç! — foli njëri nga punëtorët.

— Po ti, moj Zana, bën punën fizike?! — foli Nasufi që edhe ky i ishte betuar me bë dhe rrufe gjysmës së fshatit pér këtë mesele.

— Edhe ky është profesion i nderuar, ç'të keqë ka, apo s'është kështu?

— Po ju sikur studjonit pér laborante? — foli Prendi. — Bana qeshi dhe parafolësi vazhdoi. — Apo fjala «laborante», po ta përkthesh në gjuhën e të parëve, do të thotë «muratore»?

Zana, si pér ta përforcuar edhe një herë qeshi,

kësaj radhe me zë. Pikën diskutimit ia vuri Muçua, ustai më i vjetër i kooperativës.

— Ndëgjoni, more burra! Kjo që po ndërtojmë ne është ndërtesa ku do të vendoset laboratori.

— Ashtu? Pse gjithë këtë ndërtesë për laboratorin po e bëni?

— Kjo kthesa — vazhdoi Muçua — do të bëhet për të vendosur kabinetin agrozooteknik. Ky këtu do të jetë laboratori, ku do të punojë laborantja jona, shoqja Zanë.

Të gjithë sa qenë aty e shikuan me sy kërkues, kurse Lutua një, Nasufi dy dhe Prendi tre kishin vënë gishtërinjtë, ku një ditë më parë patën vënë themrat.

SEKRETI

Një pedagog i njohur ka thënë: «Fëmija është një «tabula rasa»...

Kurse Makarenko, kur fliste për fëmijët, a e din i çfarë thoshte?..

— E po, duhet ditur se fëmijët e sotëm lindin më të zgjuar se në kohën e Makarenkos. Apo s'e kemi djalin tonë. Dreqi vetë...

— Kurse unë them se fëmija është si majmuni — foli një nga mysafirët. — Ja po ju tregoj një shembull:

Zushi ynë jo vetëm që i di të gjitha këngët e festivalit të fundit, porse i këndon edhe me figura. A është kështu, moj grua?

— E paçi me jetë!

— Çoni gotat, se nuk jua kemi vënë kot përpara.

Atë ditë, djali i çiftit Zylali mbushi dhjetëvjetorin e lindjes. Miqtë e mysafirët, që kishin ardhë përvizitë për t'ia uruar, ishin të shumtë.

— Të kam thënë, moj grua, duhet të jesh sekret e jo t'i tregosh tjetrit zorrët e barkut — i foli Zeneli së shoqes, porsa i përcolli mysafirët.

— E pe Marijen, kur e pyete si shkonte vajza

me mësime, si e treti muhabetin? Edhe ti, more mistrec! — iu soll të birit. — Rudhe gojën dhe mos i ngjaj sat ëme! Të jesh sekret! Sekreti është një veti e çmuar e njeriut. Nuk të pyeti kush për notat që ke marrë. Dhe pastaj si t'i thoshe 6, si 9 njësoj. Nuk kanë për t'i kontrolluar në regjistër.

— Mësuesi na ka thënë që të jemi të sinqertë.

— Kur duhet po, kurse këtu nuk kishte vend sinqeriteti, se dole i trashë. Përderisa je fëmija ynë, gjithshka rëndon mbi ne.

Atë natë, Zeneli, ngaqë e kishin kritikuar në mbledhjen e kolektivit, ishte bërë nevrik. Porsa hyri në dhomë, pa arritur tek tryeza e punës, hodhi çantën nga larg. Kjo e fundit, si për inat, mori me vete edhe vazon e luleve dhe të dyja së bashku u përshëndetën në dysheme. Vazoja e qelqtë, natyrisht, u nda në tri copa. Kjo solli një ngritje të tensionit nervor të Zenelit.

Beni 10-vjeçar po shfletonte albumin me fotografie dhe, kur ndëgjoi zhurmën, ngriti kokën, pastaj duke sjellë edhe një faqe tjetër të albumit, bëri gjoja se e humbi vëmendjen.

— Hë, çfarë shikon ashtu? Ndëgjove gjë, apo jo?

— !..

— Hë, mor, folë, se me ty e kam!


— Theve vazon e luleve!

— Si dluhet vepruar në këso rastesh? A duhet t'ia themi kujt apo jo?

— Jo, duhet mbajtur sekret.

— Të lumtë. Asntu duhet. Se pastaj del llafazan e nuk të beson kush asgjë.

Beni nuk bëri zë, shenjë kjo që tregonte se edhe këtë do ta mbante sekret e nuk do t'ia thoshte ma-



mit. Faji u spostua nga babai te macja e shtëpisë, e cila edhe javën e kaluar u ngarkua nga mamaja me një faj të pabërë, sikur kjo kishte pirë qumështin.

Mamaja e këshilloi Benin që mos t'ia tregonte babait, se pastaj dilte llafazan. Beni nuk foli, e kësh-
tu macja e mjerë u ngarkua kësaj radhe edhe me një faj tjetër.

«Po unë çfarë të bëj,» tha një ditë me vete Beni, ndërsa po rrinte vetëm në shtëpi, «edhe unë do të bëj një rreng, se në fund të fundit më takon se jam edhe i vogël.»

Pasi mori shishen e bojës boshe ndër duar, deshi
të provonte shenjën. Ende s'kishte vendosur se cilën
të sakrifikonte. Një mendje i thoshte të gjuante pas-
qyrën e tualetit kurse një mendje tjetër thoshte të

gjuante pasqyrën e televizorit. Kështu, për një çast gjithshka mbetej në dilemë. Por ama, pavarësisht se kujt do t'i takonte për hise, ai do ta mbante sekret. Nuk do t'ia thoshte as mamit, as babit, se sekreti, ashtu siç i kishte thënë edhe babai, është një veti e çmuar e njeriut.

FUTBOLLISTI REZERVË

Kariera ime si futbollist nisi atë ditë që veshat fanelën me numër 9 në skuadrën e pionierëve të lagjes. U dashurova shumë pas lojës, se me thënë të drejtën e kisha edhe prirje.

Një ditë më thanë: «Je rritur tani, prandaj do të luash me skuadrën e të rinjve të qytetit». Gëzimin tim e ndava me xhaxhain, «tifoz» i flaktë i futbollit. Herën e parë për mua u bisedua në fushën plot gropë, kur zhvilluam një ndeshje miqësore me të rinjtë e qytetit fqinj.

— Cili është ai me numër 9? — pyesnin tifozët...

— Demush quhet.


— Paska të ardhme, i përdorka mirë të dyja këmbët, apo s'kenka i shpejtë.

Kur m'i thanë këto fjalë, thashë me vete: «Hapsytë, Demush, se mos të rritet mendja para kohe dhe e pëson pastaj...»

Shumë shpejt bëra një «salto» tjetër e u gjenda te «shpresat». Filluan edhe aty diskutimet për talentin tim. Ama edhe unë kusur nuk lija. Stërvitesha si asnjë tjetër. Një ditë traineri më tha:

— Nesër do të stërvitesh me skuadrën e parë.

Fluturova nga gëzimi. Ecja rrugës dhe dukej që nga larg pakënaqësia ime. Kështu u bëra futbollist i skuadrës përfaqësuese të qytetit. Më falni, hyra rezervë, domethënë... lojtar stoli.



Në blokun e trainerit nuk kisha asnjë mungesë, zbatova me fanatizëm të madh udhëzimet e tij, dhe

të dielat i prisja si dallëndyshja pranverën, me shpresa se mos... Por për mua stoli rezervë u bë vend i pandryshueshmë.

Tani po bëj autokritikë: aq shumë dëshiroja të mos ulesha në atë stol, të paktën një herë të vetme, sa më shkonte mendja edhe për keq dhe prisja se mos pësonte traumë ndonjë shok, dhe të luaja në vendin e tij. Por shqyrr, kjo nuk ndodhi. Edhe kur e pësonte ndonjë sulmues, bëheshin spostime: Gjysmëmbrojtësi kalonte në sulm dhe vendin e tij e zinte mbrojtësi. Kurse në vendin e këtij të fundit hynë, siç thoshin gojët e botës, kushërimi i dytë i gruas së trainerit.

Një ditë, traineri më lejoi të hyja në ndeshje. E ku se?! Atje ku më pëlqente mua, si qendërsulmues. Shkëlqeva në lojë, bëra golin e fitores. Por, ah sa keq!.. Brohoritjet e sportdashësve më zgjuan. Kisha qenë në ëndërr. Kaq u pikëllova, sa vendosa ta lija futbollin. Po nuk ishte e thënë ta merrja vetë atë vendim, se të nesërmen traineri më tha:

— Demush! Sikur je rënduar. Bën mirë t'ua lësh vendin të rinjve...

— Cilin vend — i thashë — stolin, apo?!

Traineri qeshi nën buzë...

Një ditë festë skuadra e veteranëve do të luante me skuadrën përfaqësuese të qytetit. Më ftuan edhe mua, kështu që vesha fanelën e veteranit.

— Cili është ai me numër 9?..

— Demush quhet, mos gabofsha, Demush Stoli'

— Mor po ky luaka për bukuri!.. Pse e ka lënë futbollin? Në cilin vit ka luajtur me të parën?..

Pasi mora një top nga krahë i majtë, kalova dy mbrojtësa, dhe me një gjuajtje të fortë e përsolla në rrjetë.

Grumbuj fanelash të bardha të veteranëve më mbuluan. Përqafimet nuk kishin të pushuar. Spektatorët vazhdonin të pyesnin me kureshtje: «Kush është ai futbolist që luan me veteranë?..» «Kur është aktivizuar me skuadrën e parë?.. Kur e ka lënë futbollin?»

TIFOZI

... E takon në çdo vend. Mund të jetë shitës apo blerës, punonjës i ndonjë qendre pune, kooperativist i thjeshtë, ose edhe njeri me shkollë e me pozitë në shoqëri. Është fjala për një tifoz të flaktë të skuadrës së tij. Pasi bën formacionin e mundshëm, jep edhe taktikën që duhet të përdorë skuadra. Po u bë kjo, fitorja nuk diskutohet. Është trainer vullnetar, në qoftë se do të mund ta quajmë kështu.

Po t'i buzëqeshë fitorja skuadrës, atëhere skuadra e tij ka në gjirin e saj «të shkëlqyerit» në sulm dhe të «çelnikosurit» ose «betonarmetë» në mbrojtje, kurse treshja e gjyqtarëve «në lartësinë e duhur». Po ngjau e kundërta, atëhere të «humburit», «mendjë-mëdhenjtë» janë përbërja e skuadrës, nga të cilët rrođhi fatkeqësia, pastaj edhe gjykimi ishte «shumë i poshtër.»

Në xhepin e brendshëm të xhaketës mban dy kalendarë; njëri i sigurimeve shoqërore, që tregon ditët dhe muajt e vitit, dhe tjetri i ndeshjeve të kampionatit e të kupave. Në këtë të fundit ka shënuar me bojë rezultatet e ndeshjeve të zhvilluara. Ðhe me laps ato të pazhvilluarat, porse të parashikuara prej tij.

Biletën që i «takon» e merr gjithnjë në të njëjtin vend: Tribuna «A», radha «midis», numri «midis» dhe për këtë derdh djersë dy-tri ditë para ndeshjes. Duke siguruar biletën, jo vetëm shijon ndeshjen, por krijon temë diskutimi për të dielën mbasdite dhe përditën e hënë.

Të dielën paradreke e gjen në vende ku mblihet «ajka» e tifozëve për të marrë apo për të dhënë bastet e vëna që një javë përpara. Të hënën u mban leksion kolegëve të tij të punës. Përcakton me saktësi vendin nga ku u bënë golat dhe faulet e ndryshme, u flet shokëve të punës, të cilët kishin patur fatin e keq ta shihnin lojën pas portave dhe vazhdojnë prapë të jenë pa fat (kësaj radhe duke mos e kupuar edhe ata vetë), se krahas komentimit të ndeshjes humbasin shumë kohë nga tatorëshi.

Eshtë lexues i apasionuar i gazetës «Sporti pullor», gjithashtu edhe ndëgjues i emisioneve sportive të radios. Kur i jepet rasti, ndjek edhe ndeshjet ndërkombe të televizion. Këto i sheh te një kushëri i afërt sipas tij, dhe i largët sipas kushërit, të cilit i ka zënë derën.

... Një të hënë po prisnim autobuzin urban për të shkuar në punë. Sapo më pa, filloi:

— Hë, e pe dje?.. Ai do pushkatuar!..

T'ju them të dretjtën, për një çast u bëra kureshtar të dija se cili është ai «kriminel» që meriton dënimin kapital. Dhe vazhdoi:

— Maskarai!.. E humbi penalltinë në fund të lojës. Na i humbi dy pikët; atij pika i rëntë në lule të ballit!..

Një plakë, që po dëgjonte, shtoi:

— Janë fëmijë e s'ke ç'u bën.

Dhe me sy shikonte një grumbull kalamajsh, që po ndiqnin maqinën e ujit prapa.

— Ta shihje Xhoden të dielën e shkuar... Të kënaqeji shpirti. Prej pikës së njëmbëdhjetëmetërshtit dhe fill e në rrjetë.

— Ka të bëjë edhe edukata e prindërve — foli plaka me seriozitet ngaqë, siç duket, mendonte se ishte në brendi të bisedës.

Për ta sqaruar plakën, i thashë:

— Punë sporti, moj nënë; kemi humbur dje.

— Edhe ju qenkeni fatosa?..

— Tifoza — korrigjova vetë duke qeshur.

— Qofshi shëndoshë, more bir, se kështu e ka loja me top. Edhe djali im, kur kthehet prej fushës së futbollit për në shtëpi, vjen me zë të ngjirur, sa me zor ndëgjohet. Le pastaj xhaketa e tij është e pamundur t'i ketë të téra kopsat në vend.

«Komentatori» filloi të jepte një panoramë rrëth ndeshjeve të kampionatit evropian të futbollit duke treguar rezultatet dhe të papriturat e tij.

Unë zbrita, kurse qytetarë të tjerë mbushën autobusin.

Kërkova me sy «komentatorin», sepse të dy zbrisnim në të njëjtin stacion, por s'e dallova dot. Siç duket kishte harruar të zbriste në stacion sepse gjeti një tifoz tjetër, po aq të zjarrtë sa ai në autobus dhe bashkarisht kishin vendosur të bënин xhiro rrëth unazës së qytetit sepse s'u mjaftoi koha në xhiron e parë.

HOTELI, VESELI DHE SPORTISTËT

Në kabinën e dezhurnit të hotelit ishte varur me spango një copë karton sa madhësia e një pagete cigareje. Në të shkruhej: «Vende për sot nuk ka». Dhe me këtë xha Eljazi kursente fjalët që duhej të bënte me klientët e ndryshëm që mund ta mësynin hotelin.

Udhëtar i fundit që i zuri derën ishte Vesel Dineja. (Kështu quhej i panjohuri). Ai, pasi lëshoi përdhe valixhen e rëndë, iu drejtua sportelistit.

— Një vend, të lutem! Kam udhëtuar gjithë ditën dhe jam i lodhur.

Xha Eljazi e vështroi nga maja e flokëve deri në fund të këmbëve, sikur do t'i merrte masën për t'i qepur ndonjë kostum:

— Kam vetëm një krevat bosh në dhomën ku flenë ata që erdhën për kampionat.

— More kush të jetë, edhe të kombinatit apo të uzinës, njësoj janë, në fund të fundit shqiptarë si të gjithë ne janë edhe ata.

Pasi mori çelësin, i shoqëruar nga moshatari i tij, u drejtua nga dhoma dhe zuri krevatin. U zhvesh dhe, sa çel e mbyll sytë, e zuri një gjumë i thellë.

Pas pak u ndëgjua një zhurmë rrënqethëse e shqëruar me britma:

— Flenë bota, more të uruar!..

— E, o xhaxho, gjumin e ëmbël bëfshin!.. «Po bie fyelli e çiftelia!..»

— Lëre more këngën! Mos të lanë?!

Pasi shkelmuani derën e dhomës së fjetjes me këmbë, sportistët filluan: «Po provohemi në mundje sambo... Ule dyshekun këtu në çimento, batanijet vendosni anash, mos të vritemi...»

— Hoop!.. Hoop!... Força, Sadush, forcaaa!.

Britma dhe shuplaka në të katër anët.

Veseli u zgjua i trembur, dhe i përgjumur foli:

— Hë, djema, ç'ka ngjarë?!. Mos u zini!.. Ndëgjoni plakun!.. Eshtë turp!..

— Kemi spartakiadë nesër. Pregatitemi, xhaxho.

— Kjo nuk ka lezet, bota flenë dhe ju ziheni!..

— foli plaku.

Në një qoshe të dhomës, një zeshkan me një gjyle në dorë, i drejtuar nga Veseli, stërvitej përzënie pozicioni.

— More ti, a je në vete, a të ka lënë mendja?!

Kë do të qëllosh ashtu?!

Një i tretë, i cili siç dukej ishte shtangist, kapi komodinën dhe, pasi futi në sirtarin e poshtëm një copë të metaltë për ta rënduar, filloi ta ulte dhe ta ngrinte disa herë që të provonte forcën e muskujve.

Tani plakut i doli gjumi krejtësisht.

— Po ty, more shok, çfarë të bën ajo komodina që nuk e lë në vend të vet?!

— Pregatitemi për ngritje peshash, more xhaxho. Nesër konkurojmë.

— Si?!. E po nesër bëj ç'të duash, tani na lërë të mbyllim sytë se vdiqëm për gjumë! Flini, more

edepzëzë, se ma keni sjellë këtu!.. — dhe dorën e djathëtë e vuri te hunda. Fliste plaku thinjosh që rrinte te kabina poshtë. Ngaqë kishte ndëgjuar zhurmën, që tronditi hotelin, u ngjit në katin e tretë.

— Po këto, more shok? — iu drejtua Veseli.

— Të thashë, more byrazer, sportistët nganjëherë e bëjnë të vetë..

Veseli u ngrit nga krevati, u vesh, mori plaçkat dhe u drejtua nga dera.

— Ku shkon, more?..

— Po dal në lulishte, zëre se doli drita.

— Jo, more shok,është ora një e natës. Hajde fli te krevati im poshtë.

— Ju falem nderit! — Të paedukuar! — shtoï thinjoshi duke mbyllur me rrëmbim derën e sportistëve.

— More këta qenkan të tmerrshëm! — shtoï përsëri Veseli. — Se sportistët, kur vijnë për të luajtur andej nga ne, zënë hotelin herët si pulat. Në vend që të stërviten, sorollaten pazarit tërë ditën, kurse tani... e pastaj, duan të arrijnë rezultate dhe të përfaqësojnë denjësit ngjyrat e qytetit të tyre.

.... Nga kati i tretë zbritën shkallëve e hynë në kabinën me xhame. Plaku thinjosh shfletoi faqet e një reviste, ndërsa mysafiri, pasi u zhvesh së dyti, u kthye në krahun e djathëtë dhe e zuri gjumi...

İSTANBUL'U KÜLTÜR

İstanbul'un kütüphaneleri, tarihi ve kültürî eserlerin saklandığı yerlerdir. Bu eserlerin birçoğu, tarihî ve kültürî değerleriyle, İstanbul'un tarihî ve kültürî mirasının temsilcileridir. İstanbul'un kütüphaneleri, bu eserlerin korunması, koruyuculuğu ve tarihî ve kültürî değerlerinin korunması için büyük bir önem taşımaktadır.

İstanbul'un kütüphaneleri, tarihi ve kültürî eserlerin saklandığı yerlerdir. Bu eserlerin birçoğu, tarihî ve kültürî değerleriyle, İstanbul'un tarihî ve kültürî mirasının temsilcileridir. İstanbul'un kütüphaneleri, bu eserlerin korunması, koruyuculuğu ve tarihî ve kültürî değerlerinin korunması için büyük bir önem taşımaktadır.

SKEÇE 10

İstanbul'un kütüphaneleri, tarihi ve kültürî eserlerin saklandığı yerlerdir. Bu eserlerin birçoğu, tarihî ve kültürî değerleriyle, İstanbul'un tarihî ve kültürî mirasının temsilcileridir. İstanbul'un kütüphaneleri, bu eserlerin korunması, koruyuculuğu ve tarihî ve kültürî değerlerinin korunması için büyük bir önem taşımaktadır.

PO VJEN EKIPI

Vetat :

Tahiri — Shef i repartit
Saluku — Brigadier i maqinerise
Nafija — Punëtore prodhimi
Dushja — Punëtore e pastrimit të repartit
Ekipi — (tre vetë)
(Ngjarja zhvillohet në ditët tona, në një ndërmarrje ekonomike).

TAHIRI — Salë!.. Saluk!.. Ku shkoi se?.

SALUKU — (duke lekuar shtypin) Urdhëro, shoku shef!

TAHIRI — Porsa më lajmëruan me telefon, do t'ë vijë në ndërmarrjen tonë një ekip pér të parë si shkon puna me gruan.

SALUKU — Me gruan e kujt?

TAHIRI — Vërë vesh gfarë t'ë them! Ata duan të dinë, se çfarë kemi bërë në pér emancipimin e gruas në ndërmarrjen tonë.

SALUKU — Ehe!.. Tani u sqarova. Unë po i them se sa shkoj në shtëpi, pasjellë punën, marr gruan e shëtis. Nuk kemi lënë shfaqje pa

parë. Me gruan shkojmë në lulishte, në birrari e në teatër.

Para pak kohësh kemi parë familjarisht filmin «Gjurmët». Të pyesin po të duan edhe këshillin e lagjes; na ka parë vetë kryetari i këshillit duke shkuar krah për krah.

TAHIRI — More Saluk, këto janë llafe. Ata duan të dinë tjetër gjë. Ata mund të pyesin se sa shoqe janë ngritur në përgjegjësi në ndërmarrjen tonë? Si e kryejnë detyrën, a jemi të kënaqur nga puna e tyre, dhe pyetje të tjera të këtij lloji.

SALUKU — Ne të kënaqur jemi mjaft, por nuk di çfarë përgjegjësie kanë gratë në ndërmarrjen tonë!

TAHIRI — Thirri Dushen e Nafijen ose kë të hasësh në repart! (Saluku del, dhe pas pak vjen Nafija). Ju sot jeni shpëtimtarja jonë...

NAFIJA — Hairli?!

TAHIRI — Po vjen një ekip për të parë punën e gruas në ndërmarrjen tonë.

NAELJA — Le të vijë. Duke punuar në maqineri do të na gjejë.

TAHIRI — (me pompozitet) Lëre maqinën!.. Sot jeni është brigadiere e repartit të maqinerisë!

NAFIJA — Brigadière? A është Saluku?!. (Duke u/drejtuar dhaga Saluku).

TAHIRI — E do puna kështunë! Sa të vijë ekipi, do fiothuash se jemi brigadiere e repartit të maqinerisë, ndërsa ti, Saluk, shko e puno punë me maqina e Nafes! Bile fshihu mos të sqiposni biesh nësy, se qenke edhe i parruar...

NAFIJA — Po unë, shoku shef, isha brigadiere, mora lejën e lindjes dhe u zëvendësova me Salukun. Sapo dola në punë, ju thatë: dil një herë në maqinë, pastaj shohim. Kështu që u bënë dy vjet nga ajo ditë. Tani ç'hyt brigadierja?!

TAHIRI — E, pra, moj Nafe, bëhen gabime, por çdo gjë do të ndreget. Ndëgjo këtu: të dish të përgjegjesh, kur të të pyesin; 120% e kemi realizuar planin si global, 7% e kemi ul koston e prodhimit, kemi kursyer... (Hyn Dushja me fshesë në dorë.) Ku ishe?..

DUSHJA — Po pastroja merimangat e korridorit. Ishin për ibret...

TAHIRI — Lëre, moj, fshesën!.. Fshihe në ndonjë qoshe (me seriozitet). Sot jeni emëruar kontrollore e cilësisë!

DUSHJA — Si the?!

TAHIRI — Sot do të zëvendësosh Tomin, që kontrollon cilësinë e prodhimit. E kuptovë?.. Nuk do të jesh punëtore e pastrimit, por kontrollore e cilësisë.


DUSHJA — Po kush do t'i pastrojë zyrat e administratës, korridorin, dhomat...?

TAHIRI — Sot do të vijë një ekip për të parë punën e ngritjes së gruas në përgjegjësi, d.m.th. punën tuaj. Nuk duam të na nxihet fytyra...

(Në këto e sipër vjen ekipi i përbërë nga tre vetë).

TAHIRI — Urdhëroni!.. Mirë se keni ardhur!

ANËTARI I — (Pasi përshëndetet me të gjithë). Po ju, shoqe?.. (Nafijes).



NAFIJA — Punoj në repartin e maqinerisë.

TAHIRI — Është brigadiere e repartit.

ANËTARI I — Gëzohem!...

TAHIRI — Kjo shoqja është kontrolllore e cilësisë së prodhimit.

ANËTARI I — Si shkoni me punë? Keni hasur në vështirësi?..

NAFIJA — Çfarë të them! — Së pari e pata të vështirë ta mësoja maqinën, kurse tashti e drejtoj shumë mirë; bile tejkaloj edhe normën 15-20%.

ANËTARI II — Qëkur e keni marrë drejtimin e repartit?

NAFIJA — E kisha para dy vjetësh. Mora lejën e lindjes dhe u zëvendësova me një shok. Kur u ktheva në punë vendi ishte i zënë

dhe kështu punova në prodhim.

ANËTARI I — Ashtu-e!? Domethënë këto janë emërimë të reja?...

TAHIRI — Si urdhëron! Komunikime të reja. Se emërimi u është bërë para do kohësh, mi-répo ka munguar shefi i kuadrit dhe nuk mundëm t'i shpallnim.

ANËTARI I — Kjo është turp, shoku shef! Kjo nuk ju nderon aspak! Këto shoqe, deri para pak orësh ishin në prodhim, ndërsa...

DUSHJA — Kurse tani u paraqit situata të kalojmë në administratë.

ANËTARI II — Shkuam në administratë, pothuajtërë meshkuj, hymë në repartin para këtij, drejtuesit po meshkuj. E njejta skenë edhe në repartin tuaj.

NAFIJA — Po besa, me folë të drejtën, shumë keq!.. Vetëm përgjegjësen e gruas e kemi femër, kurse tjetër post nuk gjëzojnë gratë në ndërmarrjen tonë.

ANËTARI I — Ashtu-ë?!. Tjetër, çfarë keni për të thënë?.. Flisni!

DUSHJA — Ja se po flas unë. Herë të tjera, kur të vini kështu ekip për kontroll, bëni çmos e merrni edhe ju një shoqe me vete, e mos hajdeni si sot, tërë meshkuj! Pasi kjo, siç po e shikoni edhe vetë, i ngjet kësaj udhë-heqjes së ndërmarrjes sonë...
(Ekipi shtanget në vend).

KURA MË E MIRE...

V E T A T

Mjeku

Pacienti

Infermierja

(Skena paraqet pamjen e një ambulance të thjeshtë.)

PACIENTI — Me leje, shoqe, cili numër hyri?
INFERNIERJA — Pesa!

PACIENTI — Tani e ka gjashta, dhe gjashta jam unë. (Infermierja e fton për vizitë).

Shoku doktor, jam shumë i sëmurdë. Ju lutem, më bëni derman.

MJEKU — Nga se vuani?..

PACIENTI — Vuaj nga një sëmundje e rëndë. Jam keq me nerva.

MJEKU — Si ju shfaqet, me dridhje?..

PACIENTI — Më keq.

MJEKU — Apo ke pagjumësi?!

PACIENTI — Edhe më keq.

MJEKU — Urdhëro folë!

PACIENTI — Kryesisht e kam me shamatë, shkoj

në shtëpi dhe, po s'e gjeta gjellën gati, filloj e grindem me gruan.

MJEKU — Ashtu, ë?!

PACIENTI — Kur më bëjnë fëmijët zhurmë, e nuk më lënë të lexoj gazetën, bëj namin mbi ta. Po të mos jetë gruaja që të më qëtësojë me ndonjë kafe apo kakao, e humbas fare.

MJEKU — E çuditshme!

PACIENTI — Bile, shoku doktor, një ditë gruaja kishte harruar të më hekuroste pantalonat. Sherr që ngrita. S'lashë fjalë pa i thënë. Je e hutuar, marroqë, e pakujdeshime, e çfarë më erdh përgojë. S'e përbajta dot veten.

MJEKU — (Me ironi) Nervat janë sëmundje e vësh-tirë, por e shërueshme. Në qendër të punës ku punoni, bëni fjalë ndonjëherë?..

PACIENTI — Rrallë, shumë rrallë kryesisht me ndihmësin tim. Kur ai nuk më rri gati për çfarë t'i them, atëhere filloj shamatën.

MJEKU — Me shefin e repartit kenë bërë ndonjë-herë fjalë?

PACIENTI — Jo!. Asnjëherë nuk më ka rastisur të bëj. Është shumë i mirë!

MJEKU — Po me drejtorin e ndërmarrjes suaj, a keni bërë fjalë ndonjëherë?

PACIENTI — Kurrë nuk kam ndërruar as edhe dy fjalë të hidhura me të. Nuk e keni idenë sa i mirë është! Bile është edhe njeri i thjeshtë. Shpesh, gjatë kohës së lirë rrimë së bashku, shkojmë në sport, në kinema, etj.

MJEKU — Ashtu!.. (Me zë të lartë) E po nervat kështu e kanë.

PACIENTI — A ka ndonjë ilaç, ju lutem? Më bëni
derman!

MJEKU — Ju duhet t'i nënshtroheni një kure të
rëndë.

PACIENTI — Jam gati, shoku doktor, për çfarë të
thoni!

MJEKU — Gruaja ku punon?

PACIENTI — NISH — veshmbathje. Është rroba-
qepëse.

MJEKU — Shumë mirë! Kur të shkoni në shtëpi,
puna e parë që do të bëni është...

PACIENTI — Si urdhëron!

MJEKU — Të shpërvilni, mëngët.

PACIENTI — Si urdhëron!

MJEKU — Dhe filloni t'i vini në ndihmë gruas në
punët e shtëpisë. Bile, në qoftë se dëshironi
të shëroheni shpejt, mos prisni asgjë t'ju
vijë e gatshme, porse mundohuni ta bëni
vetë. Pas gjashtë muajsh hajdeni për-
kontroll.

JAKU NË «OPERATIVITET»

V E T A T

Jaku

Cufi

Gjoka Punonjës të administratës së ndërmarrjes
Fatimja

Një qytetar

(Ngjarja zhvillohet në ditët tona. Para perdes).

JAKU — Me leje, shok! A e di se ku e ka shtëpinë
Cuf Danga që punon në NSHN?

QYTETARI — Jo... Unë njoh një Cuf, Cuf me çantë
dhe me gjyzlykë, e jo këtë që po thua ti.

JAKU — Po, more shok, ai vetë është. Çanta i du-
het për shkresat.

QYTETARI — Tek ai pesëkatëshi e ke. Në katin e
dytë.

JAKU — Ju falem nderit!.. O Cuf.. O Cuf Danga!

NJË ZË GRUAJE — Kush thërret tanë natën?

JAKU — Më falni, shoqe... A është Cufi në shtëpi?

ZËRI — Po, ka rënë në gjumë. Ka pirë edhe një
aspirinë se kishte dhembje koke.

JAKU — E kaloftë me shëndet!

ZËRI — Ç'e deshe Cufin?

JAKU — Lajmërojmë se nesër, të gjithë punonjësit e administratës së ndërmarrjes sonë kanë punë në banesat që jemi duke ndërtuar me kontribut vullnetar. Asnjë të mos mungojë! Qartë? Hapt, ma bëfshi natën e mirë!.. (Pauzë, Palos letrën). Po Gjoka ku do ta ketë?.. Këtu pranë, po se ku nuk e di!.. (Merr një gur dhe i bie një xhami të dritares).

NJË ZË — Hë, more? Kush gjuan me gur?..

JAKU — Unë, moj shoqe... desha..

ZËRI — Ikë, mor vaga... vagabond tamam je!

JAKU — Unë desha Gjokën!

ZËRI — Çfarë Gjoke more, kujt ia shet ato!.. zhduku!

JAKU — Mbaje gojëni, shoqe! Unë kryej një detyrë të rëndësishme, për hir të interesit të përgjithshëm. (I bie një xhami tjetër.)

NJË ZË — Kush është?

JAKU — Me leje, shok! Ku e ka shtëpinë Gjokë Stani?

ZËRI — Ai llogaritari?

JAKU — Po, dora vetë.

ZËRI — Gjokë!.. Gjokë!.. Dil se të kërkojnë!

GJOKA — (I veshur në pizhama, del në paraskenë.) Hë, more, çfarë ka ngjarë?!

JAKU — Nesër, shoku Gjokë, që të gjithë punonjësit e administratës së ndërmarrjes sonë kanë punë në banesat që jemi duke ndërtuar me kontribut vullnetar. Asnjë të mos mungojë!..

GJOKA — Po ty, kush ta ngarkoi këtë detyrë natën?

JAKU — Interesi i përgjithshëm, shoku Gjokë. Di-

kush do ta bëjë këtë punë. Natën e mirë! Hyrë brenda, se do ftohesh! (me vete) «Tani më duhet të shkoj te Maksuti. Ata flejnë herët, që me pulat...»

(Hapet skena. Ambient pune. Jaku me dy kova në duar duke mbajtur llaç).

JAKU — (Gjokës dhe Cufit) Po ju?.. Tani vihet në punë?

CUFI — Nuk është vonë, sapo ra ora 7!

JAKU — A e dini se kjo kockë e ka filluar punën pa zbardhur drita?! Kam bërë tri lëmë llaç gjer tani...



CUFI — Të lumtë!

GJOKA — Kur na qenke bërë kaq punëtor!.. Vjet, kur pate muajin e punës në prodhim, i bëje bisht.

JAKU — Nuk jam ai Jaku që ka qenë vjet. Sot ke të bësh me një Jak këmbë e kokë revolucionar! (Kalon një vajzë para perdes... Shumë vonë!.. neve na ra bretku, kurse ju e nënvllefësoni interesin e përgjithshëm... Me ju e kam, shoqja Fatime! (Nga jashtë ndëgjohet: — Ujë!.. ujë!) — Erdha, shoqëri! Ja, arrita!.. (Del me vrap).

GJOKA — Çuditem me këtë ndryshim të Jakut!

CUFI — Edhe unë! Ai punëve të zyrës mundohet t'u bëjë bisht sa herë. Mbaroi 6-mujori, dhe hala s'e ka mbyllur bilancin.

GJOKA — E-he!.. Ai është dhelpër e vjetër! E di mirë pse bëhet copë kështu!

CUFI — Ndoshta do që t'i hyjë në qejf drejtorit të ri.

GJOKA — Është tjetërkund halli.

CUFI — Ma trego! (Jaku kalon me karrocë duke u buzëqeshur shokëve.)

GJOKA — U ndanë hyrjet e kësaj banese që jemi duke përfunduar... (Jaku, me dy kova në duar, hyn në skenë dhe zgjat veshët të ndëgjojë bisedën. Bën gjoja se i është zgjidhur këpuca dhe e lidh).

JAKU — M'u zgjidh dreqi!..

CUFI — (Gjokës) Kur u bë kjo punë?..

GJOKA — Mbrëmë, që patëm mbledhjen e komisi-

onit për strehimin e punonjësve.

JAKU — (Kthehet.) Më falni... S'është mirë që ju ndërhyj në muhabet, po... ku e kishit fjalën?

GJOKA — Asgjë me rëndësi! Po i tregoj Cufit se u ndanë hyrjet e banesës që po ndërtojmë.

JAKU — (I prerë) Me gjithë mend, apo tallesh?!

GJOKA — Jo! Nuk tallem.

CUFI — Kush i mori?..

GJOKA — (Autoritar, nxjerr një blok shënimesh ku gjoja ka të shkruar emrat e shokëve.) Në katin poshtë djathtas, e mori Paulina.

JAKU — Me gjithë mend? Pa shiko! Bukur fort!

GJOKA — Përkarshi e mori Frosina!

CUFI — Po më vjen mirë, se ka edhe një tufë fëmijë. Po pastaj?

GJOKA — Në katin e dytë e mori Iljazi.

JAKU — Ç'thuas more? I lumtë!

GJOKA — Anën tjetër shoku Llazi!

CUFI — Oh, sa mirë po më vjen, se i bie edhe dielli! Shyqyr, se ai ka edhe reomatizëm.

GJOKA — Në kat të tretë e mori Azemi.

JAKU — Mos bën lodra, Gjokë!?

GJOKA — Edhe një hyrje Muharremi.

CUFI — Edhe ai e meriton... Bukur fort! Po më tutje?

GJOKA — Kaq ishin për këtë radhë. Morën ata që kishin nevojë më urgjente.

JAKU — (Lëshon kovat përtokë dhe turbullohet.)

CUFI — Ç'pate, shoku Jak? Ç'të gjeti?

JAKU — Po më merren mendtë... (Nga jashtë ndëgjohet: — Ujë! — Ujë! Jaku afron kryet te kova e ujit. Cufi e lag me ujë.) Kjo kovë më

duhet për vete. Nuk ndjehem mirë...

GJOKA — Një lojë bëmë dhe e patë se ç'pësoi Jaku.

JAKU — (Që e ka ndëgjuar fjalën «lojë», çon kokën prej kovës së ujit) Lojë qe kjo?!. Domethënë nuk janë ndarë ende? (Nga jashtë: Na bjerë llaç, më shpejt! Hajde, Jak, mos vono... Jaku duke u ngritur) Erdha... erdha!

(Mezi ngrihet se i merren këmbët. Të dy shokët qeshin...)

TE KALITUR ME GENJESHTRA

V E T A T :

Remziu

Taçi

Drita

Irfani

Arta

Eva

(Ngjarja zhvillohet në një ndërmarrje ekonomike në ditët tona).

REMZIU — Ku dreqin u zhduk?! (Nga spektatorët)
A e patë nga vajti?.. Më falni, ju nuk e njihni... (Ndëgjohet një këngë jashtë skene.)
Taçi, për fjalë të nderit, e njoh në gurmaz, unë. Taç, more!

TAÇI — Urdhëro, shoku shef!

REMZIU — Ku je? Më ranë këmbët e nuk të gjeta, nga u zhduke?

TAÇI — Edhe unë plasa të zë ndonjë peshk... Mbrëmë, për fjalë të nderit, më zuri mesnata tek ura. Nuk zura gjë. S'bien në grep fare...

REMZIU — Mos folë marrëzira! Të është bë-

rë mëndja peshk. Ndëgjo këtu... Po vjen një ekip për të parë gjendjen fiskulturalo-sportive të ndërmarrjes sonë.

TAÇI — Ma thuaj më shkoqur!

REMZIU — Duan të dinë si i kemi punët me kalitjen fizike.

TAÇI — Me kalitjen fizike? Për fjalë të nederit, jemi më të fortë se kurrë! (I tregon muskulin e krahut.) Provo ta ngulësh thikën... Kërcen thika, sikur të qëlloje në gur!

REMZIU — Ndëgjo, Taç... Lëri dokrrat! Ekipi nuk do të dijë vetëm pér ty, por pér të gjithë kolektivin e ndërmarrjes.

TAÇI — Aha. Aty e kemi pisk. Përshembëll Cufi, tani ka dalë nga spitali... I ka muskulat quall, edhe Xhija nerva ka, por muskula s'ka fare.

REMZIU — Ti ke pirë sot, e shoh unë.. Te personi yt varet fati i ndërmarrjes. Të kemi zgjedhur përgjegjës pér aktivitetin fiskulturalo-sportiv. Hap sytë na nxirr faqe bardhë!. . (Hyn Arta).

ARTA — Shoku Remzi... Kanë ardhur tre-katër vetë dhe ju kërkojnë.

REMZIU — Kujdes-ë!. . (Artës) Tani po vij. Tregohu i shkathët, Taç, sa ta hedhim lumin...

TAÇI — Mos u merakos! (Nxjerr bilbilin). Një, dy, tre... Shpërndahu! (Nga spektatorët) Nesër në orën katër të gjithë në stërvitje! (Ekipi i kontrollit ka hyrë në skenë. Taçi i sheh me vonesë). Më falni!.. Mirë se erdhët!

REMZIU — Shoku është caktuar...

TAÇI — (Prezantohet) Taç Plepi! Brigadier, dhe njëkohësisht i ngarkuar pér mbarëvajtjen e sportit në ndërmarrje.

DRITA — Gëzohem! Si vete puna?

TAÇI — Mirë! Pse të anko hemi!

DRITA — Çfarë keni bërë pér kalitjen fizike të punonjësve në ndërmarrjen tuaj?

TAÇI — Jemi kalitur. Edhe individualisht edhe kolektivisht.

IRFANI — Me cilën degë të sportit janë marrë më tepër punonjësit tuaj?

TAÇI — Si degë, s'di çfarë të them... Përshembej, në këndin e kuq të ndërmarrjes kemi vendosur një televizor. Atje shohim ndeshjet e sportit kolektivisht. Kemi parë «Ajaksin» e Hollandës me atë «Panathatakos» a qysh i thonë... Kemi parë...

DRITA — (E ndërpret). Ju vetë a merrni me sport?

TAÇI — Jo! Unë jam si trainer vullnetar.

DRITA — Shumë mirë! Çfarë sporti stërvisin?

TAÇI — Skuadrën e futbollit. E kemi shqepur ndërmarrjen që kemi përkarshi. (Bën me shenjë nga hyrja e ndërmarrjes).

DRITA — Me sportin e notit, merreni?

IRFANI — Posi! Ja përshembull, verën që shkoi kemi shkuar kolektivisht në Shëngjin.

DRITA — Po me qitje merret kush në ndërmarrjen tuaj?..

TAÇI — Posi... Kemi Dylin, rojen e ndërmarrjes. Ka një mavzer gjerman që të than. Vjet vrau një ujk këtu e 800 metra larg.

IRFANI — Një qitës ka ndërmarrja juaj?..

TAÇI — Edhe shokun Remzi e kemi qitës të mirë.

DRITA — Edhe ju merreni me qitje?

REMZIU — (I zënë ngushtë). Si urdhëron, kam bë
rë qitje në zbor...

TAÇI — Është gjuetar i mirë, shoqe. Ka vrarë mjaft
rosa dimrin e shkuar. Apo s'ka një çifte...

DRITA — Gjimnastikën e mëngjezit, e zhvilloni rre-
gullisht?

TAÇI — Këtu kemi avari. Ua kam lënë detyrë që ta
bëjnë në shtëpi, për vete, kështu që... Besoj
se kuptohemi..

IRFANI — (Me ironi) Po kuptohemi që mos e pyet!

DRITA — Po me elementin femër, ç'keni bërë? Ka-
në marrë pjesë në sport, apo u keni sjellë
pengesa?

TAÇI — Aspak. Përkundrazi, vetë shoku Remzi, u
ka dhënë ndihmën e duhur.

DRITA — Konkretisht?

TAÇI — Përgjegjuni edhe ju, shoku Remzi, se unë u
lodha. (Në këtë kohë, Arta me një shoqe
dalin në skenë me rrjeta në krah. Brenda
kanë kostumet sportive. Përshëndesin të
porsaardhurit dhe i drejtohen fundit të ske-
nës). Po ju?..

ARTA — Mbaruam punën dhe po shkojmë, se kemi
stërvitje pasdreke.

TAÇI — Stërvitje?!.. Po tani sapo ra 12 sahati!

ARTA — Jemi 5-orëshe...

REMZIU — 5-orëshe?!

ARTA — (Qesh) Merremi me sport, shoku Remzi,
dhe gjëzojmë të drejtën e orëve të reduk-
tuara.

EVA — Jemi edhe anëtarë të ekipit të volejbollit
të rrethit.

TAÇI — (I gjëzuar) Ashtu?! Po hajdeni dhe na bëni
një ndeshje t'ju shohim!

ARTA — Ndeshja bëhet aty ku është vendi, shoku Taç, e jo këtu para teje. Po ti fle, shoku Taç, gjithnjë fle. Vjet ekipi i volejbollit i ndërmarrjes sonë zuri vendin e dytë në rrëth ndërmjet skuadrave të ndërmarrjeve, kurse ju...

TAÇI — Vendin e dytë? Pse nuk zutë vendin e pa-rë.. S'ju vjen turp!...

EVA — Turp të keni ju, që jeni ngarkuar për kali-tjen fizike të kolektivit, dhe s'bëni asgjë!

ARTA — Edhe shoku Remzi, si përgjegjës reparti, shpesh është bërë pengesë, sidomos në rre-gullimin e turneve gjatë aktiviteteve...

DRITA — Ju falemi nderit! Kaq deshëm. Rruga e mbarë ju qoftë! Gjithherë suksese paçi!

TAÇI — Suksese duke kritikuar përgjegjësin e spor-tit!..

DRITA — Ua bënë mirë. Mos harro se ky do të jetë vetëm fillimi.

TAÇI — Pse ka edhe më?.. Unë s'i duroj. Le të përgjegjet shoku Remzi se, në fund të fundit, ai është përgjegjës për të gjitha. Unë, që ta dini hollë-hollë, jam si biçim bedeli, dhe as-gjë tjetër. Apo s'është kështu, Remzi? Folë!... (Mundohen t'ia lënë njëri-tjetrit).

DJALI I ÇERDHES SONË

V E T A T

Leka — Kryetari i kooperativës bujqësore

KATRINA — Punonjëse e çerdhes së kooperativës.

LACINI — kooperativist

Shpresa

Sokoli pjestarë të një ekipi të ardhur nga qyteti.
(Para perdes).

LACINI — Katrinë! Katrinë!.. Kate, moj dreq! Se
nga e këputi...

(Vjen Katrina). Ndëgjo këtu dhe vërë vesh mi-
rë çfarë po të them: Kanë ardhur ekip nga ata të
seksionit të shëndetësisë të shohin si funksionojnë
çerdhet e kooperativës sonë. Pastroje mirë, dhe pre-
gatitë të përgjegjesh po të të pyesin gjë.

KATRINA — Për çfarë do të më pyesin?..

LACINI — Ku ta di unë.. Ndoshta mund të të py-
sin se sa fëmijë ke.

KATRINA — Jam martuar tani, ende s'kam fëmijë.

LACINI — Jo, moj shoqe. Sa fëmijë ka çerdhja e
kooperativës. Se sa fëmijë ke ti, atyre nuk
u duhet gjë.

KATRINA — Kur do të vijnë sot? Apo...

LACINI — Zëre se erdhën. I lashë te mensa, atje poshtë. E bënë për dy pare Asllanin, kuzhinerin, se e gjetën pa bluzë të bardhë.

KATRINA — Unë jam gati... s'kam çfarë bëj...

LACINI — Mos rri duarkryq. Pastro pluhurat, ose së paku shko e këndoju fëmijëve nina-nana, po qe se nuk i ka zënë gjumi.

(Hapet perdja, Shpresa dhe Sokoli vijnë në skenë).

KATRINA — Mirë se erdhët! Urdhëroni!...

SHPRESA — Kjo është çerdhja e kooperativës?..

LEKA — Si urdhëron, kjo është!

SOKOLI — I sjellin kooperativistët fëmijët e tyre në çerdhe rregullisht, apo jo?

KATRINA — Po, besa! Berekaversëm, të mos qanemi. I sjellin, pse jo.

SHPRESA — Qënkan fëmijë të shëndetshëm. Edhe çerdhja qenka e rregullt. Edhe për sa i përket frekuentimit, siç po duket, nuk e paskeni problem.

SOKOLI — Puçi-puç... E kujt është ajo fëmijë? (Tregon më dorë një fëmijë.)

KATRINA — Vajza e Andonit, një kooperativistiktoni.

SHPRESA — Simpatike!.. Po ajo me sy të zez?..

KATRINA — Ajo në qoshe këtej është vajza e shofërit të kooperativës, kurse kjo te dritarja është e një stallierit këtu te ne.

SOKOLI — Qenkan mirë, si buçko të gjithë. Po kjo?..

KATRINA — Ajo me flokët e verdhë éshtë e agro-nomit, e quajnë Pranvera, dhe siç e shikoni kështu gjithnjë rri, e qeshur...

SHPRESA — (Përkëdhel një fëmijë)...

KATRINA — Antoneta, përshtendete tetën! Vjollca, (i bën zë një fëmije tjetër) tregoi xhaxhit si bën macja...

SHPRESA — (Kryetarit të kooperativës). Më falni, se po ju pyes. Vetëm vajza keni në çerdhe, apo?..

LEKA — Si urdhëron! 17 vajza dhe një djalë...

SOKOLI — Me të vërtetë sot nuk ka asnjë rëndësi djalë apo vajzë. Kjo éshtë mbeturinë e së kaluarës. Megjithatë të bën përshtypje ky disproporcion seksesh, a thua se nuk kanë lindur djem në fshatin tuaj!..

KATRINA — Djem ka me bollëk. Bile më tepër se vajza. Por ç'e do se nuk i sjellin në çerdhe, i mbajnë me kimet...

SHPRESA — Po çuditem!.. Mos me ta marrë mendja.

SOKOLI — Domethënë nuk i sjellin?.. (Shikon kryetarin.)

KATRINA — Shikoni këtë (bën me shenjë për të vetmin djalë) ka edhe 6 vëllezër të tjerë, se as këtë nuk do ta kishin sjellë.

SOKOLI — Shoku kryetar, po ju sikur thatë se i kenë luftuar zakonet prapanike në fshatin tuaj? Po a nuk éshtë edhe ky një zakon prapanik?..

LELA — Unë po çuditem, për fjalë të nderit!..

KATRINA — Jo, shoku kryetar, mos u çuditni aspak. Edhe vëllai juaj, kur i lindën 2 binjakë, vajzë dhe djalë, vajzën e sillte në

çerdhe, kurse djalin gjoja se e kishte të së-murë, ia linte nënës që ta riste.

LEKA — Për fjalë të nderit, kjo nuk më ka shkuar në mend. Sa për djalin e vëllait, ai ka qenë mjaft i dobët. Çfarë t'ju them tjetër!?



Djali i çerdhes sonë

PASQYRA E LËNDËS

Faqe

TREGIME:

Rrapushi përgjegjet	3
Pula e Sadiikut dhe thatësira	7
Biçikleta «Mifa»	11
Referati	16
Ekspozita	20
Justifikimi	24
Administratori i familjes	29
E do zakoni	33
«Sëmundje» me shërim	36
Konflikti	41
Laborantja	46
Sekreti	50

TREGIME PËR SPORTIN:

Futbollisti rezervë	57
Tifozi	61
Hoteli, Veseli dhe sportistët	64

SKEÇE:

Po vjen ekipi	69
Kura më e mirë	74
Jaku në «Operativitet»	77
Të kalitur me gënjeshtra	83
Djali i çerdhes sonë	88